# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7599 E martë 24 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga VASIL KURETA

## SHBA-Rusi, normalizim i marrëdhënieve dhe i dialogut



Takimi mes presidentit amerikan, Trump dhe presidentit të Rusisë, Putin përbën realisht një zhvillim të rëndësishëm. Edhe pse nuk është njohur plotësisht ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga DOMINIQUE MOISI

## "Rusi 2018", topi që zbuti botën



Filozofi dhe satiristi i shekullit të shtatëmbëdhjetë, Jean de La Bruyère, dikur thoshte se: "Corneille i portretizon burrat ashtu siç ata duhet të jenë, Racine ...

Vijon në faqen 21

EMRAT/ AGJENCIA E PRONAVE PUBLIKON LISTEN E PERFITUESVE TE FONDIT

# PRONARET, KOMPENSIMI PER DOSJET E 1993-2000

Formula, 20% e vlerës në para dhe 80% kompensim fizik. Pronarët që kanë vlerësimin financiar duhet të dorëzojnë dokumentet pranë ATP-së



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

Në faqen 7



Krimet e Rënda kundër ish-kryeprokurorit

## Sekuestro pasurive të Adriatik Llallës, dyshimi: 98 milionë lekë të pajustifikuara

Gjykata vendos bllokimin e apartamentit në Durrës dhe 4 sipërfaqeve tokë arë në Tiranë

TIRANË-Gjykata e shkallës së Parë të Krimeve të Rënda në Tiranë me kërkesë të prokurorisë ka vendosur sekuestro preventive mbi disa pasuri të ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. 22 mijë e 50 m2 tokë dhe një apartament banimi në Durrës janë bllokuar me argumentin se janë produkt i aktiviteteve kriminale. Burime zyrtare nga ...

Në faqen 3

VENDIMI I GJYKATES

### Vjedhja e bankës te Blloku, 13 vite burg për Litin, 1.6 për Babameton

Në faqen 10

HISTORI

### "Bella Venezia", aty ku pastiçerët përgatitën tortën e dasmës së Zogut

Në faqen 9

"VIP PAGES"

### Drilon Hoxha, mes krimit dhe pasionit: Çelësi i suksesit, familja

Suplement

MBYLLET KUVENDI



### Lulzim Basha: 7 kushte për konsensus politik me maxhorancën

Në faqen 6

31-vjeçarja rrëfen: Të parën e bëra se isha e dehur, festova ditëlindjen

## Grabitësja e karburantit: E bëra për hakmarrje

*Anna Malaj bashkëpunoi me kushëririn: Ma hodhën te kursi i këmbimit*

Gjithçka nisi si aventurë, por ishte edhe hakmarrje. Grabitjen e parë e kryem në gjendje të dehur, pasi festova ditëlindjen. Bashkë me kushëririn tim, Emiljanon shkuam te pika e karburantit në fshatin Levan, pasi disa kohë më parë, punonjësi i këtij karburanti ka gabuar me kursin e këmbimit. Edhe pse debatova me të, punonjësi nuk më ktheu reston e duhur, ndaj dhe u hakmora ndaj tij". Kështu ka deklaruar para hetuesve të çështjes, 31-vjeçarja Anna Malaj nga fshati Visokë ...



Në faqen 10

LISTA E DYTE

### Dosjet e viteve '97-'98, formulari për të marrë pagesat e përshpejtuara

Në faqet 11-12

## GJYQTARET & PROKURORET

### VETINGU

KPK: Ka burime të mjaftueshme financiare për të justifikuar likuiditetet e pasurinë

# Gjykatësi i Lartë, Dvorani drejt rikonfirmimit në detyrë

### "Kam gabuar, por s'jam i pandehur të shpëtoj me procedurë"

Klodiana Lala

**TIRANË**

Anëtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani, u përball dje me institucionet e vetingut në seancën dëgjimore publike. Të gjitha mundësitë janë që gjykatësi i karrierës ta kapërcejë me sukses filtrin e trefishtë të kontrollit. Në shtyllën e pasurisë, e vetmja pikëpyetje që ngrihej lidhej me mosdeklarimin nga ana e Dvoranit e llogarive bankare në deklaratën veting, por që është konsideruar harresë dhe jo fshehje pasurie. Në raportin e KPK-së thuhet se, pavarësisht se ILDKPI shprehet se gjykatësi ka kryer fshehje pasurie, nga hetimi administrativ është provuar se llogaritë bankare në emër të tij, bashkëshortes dhe personave të tjerë të bashkëlidhur janë deklaruar ndër vite, por jo në deklaratën veting. Komisioni u shpreh se ILDKPKI përpara se të hartonte raportin, duhej ta thërriste subjektin dhe ta pyeste për mosdeklarimin e likuiditeteve në shumën e 9.9 mln lekëve, për sa kohë gjyqtari i lartë është shprehur se ishte harresë për shkak të punës. Sipas komisionit, pavarësisht gjetjeve të Inspektoratit, nga hetimi është provuar se Dvorani ka burime të mjaftueshme financiare për të justifikuar jo vetëm likuiditetet, por të gjitha pasuritë për të cilat ka bërë deklarime të sakta. Në të njëjtën linjë me komisionin ishte edhe vetë subjekti, cili pranoi se ka pasaktësi në plotësimin e deklaratave, ku siç shpjegoi, konstatoi me shumë vonesë që mungonin katër faqe, por pavarësisht kësaj, nuk u thirr asnjëherë nga Inspektorati për të dhënë shpjegimet e tij. "Kurrë s'kam mbajtur para poshtë dyshekut, por i kam deklaruar gjithmonë në bankë. Nuk ndjehem krenar se kam plotësuar gabim deklaratën e pasurisë, por kjo s'ka pasur për qëllim të fshehë ndonjë gjë. Ka qenë thjesht pakujdesi për shkak të ngarkesës së punës. ILDKPI-ja s'më ka thirrur kurrë për të verifikuar çfarë pretendon ndaj meje", tha Dvorani. Ndërkaq, ai i solli në vëmendje komisionit se procesi ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të jetë i rregullt, t'iu garantohen të drejtat dhe liritë e tyre. Sipas lektorit të së drejtës, gjykatësit dhe prokurorët në këtë proces nuk janë as të paditur. Në këtë mënyrë, gjykatësi i lartë tentoi të përçonte mesazhin që një subjekt të kalojë procesin e rivlerësimit duhet të jetë i vërtetë dhe i ndershëm e jo të fshihet pas kleçkave procedurale. Sa i përket komponentit të dytë të vetingut, figurës morale, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka deklaruar se Ardian Dvorani është i përshtatshëm për vijimin e detyrës, pasi nuk ka asnjë dyshim për përfshirjen e tij në korrupsion dhe s'ka asnjë lidhje me eksponentë të krimit. Dvorani u vlerësua pozitivisht edhe për aftësitë profesionale. Gjatë seancës dëgjimore, gjykatësi i lartë i kujtoi komisionit se gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë as të pandehur as të paditur. Sipas tij, në këtë proces nuk synohet vetëm që subjektit i rezervohet e drejta për t'u dëgjuar, por e para ata duhet të sillen me dinjitet për karrierën e tyre. Për lektorin e së drejtës, integriteti i gjyqtarit e prokurorit nuk vjen vetëm nga salla, por edhe sjelljen jashtë gjyqësorit. I pyetur përse vazhdon të qëndrojë në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që mandati i ka përfunduar prej 4 vitesh, e madje për të ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese që e detyron të largohet, Dvorani dha edhe një shpjegim. Vendimi për ekspertin e ligjeve të reformës në drejtësi pritet të shpallet më datë 25 korrik.



Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani



Ardian Dvorani gjatë seancës së djeshme dëgjimore në KPK

**DEKLARATA E DVORANIT**

"Kurrë s'kam mbajtur para poshtë dyshekut, por i kam deklaruar gjithmonë në bankë. Nuk ndjehem krenar se kam plotësuar gabim deklaratën e pasurisë. Por kjo s'ka pasur për qëllim të fshehë ndonjë gjë. Ka qenë thjesht pakujdesi për shkak të ngarkesës së punës. ILDKPI-ja s'më ka thirrur kurrë për të verifikuar çfarë pretendon ndaj meje", u shpreh gjyqtari i lartë, Dvorani.

**GJYQTARI FAQOLLI NË KPK**

Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Astrit Faqolli (kandidat për KLGJ) u përball dje me KPK. Sipas komisionit, ILDKPKI ka dorëzuar një raport ku konstaton se gjyqtari ka kryer deklarim të saktë, ka burime të ligjshme dhe nuk ka fshehje pasurie. Sipas KPK, DSIK ka dalë në përfundimin se gjyqtari është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, ndërkohë që ky informacion është i pasaktë dhe i pabazuar në prova dhe fakte.

## "Gjyqtari i lartë nuk justifikon 99 mln lekë"

### PD kundër rikonfirmimit të Dvoranit, deputeti Strazimiri: "Çanta" e Xhafajt u mbrojt nga Rama

**TIRANË** - Partia Demokratike reagoi kundër anëtarit të Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani, i cili pritet të rikonfirmohet në detyrë. Pas përfundimit të seancës dëgjimore në KPK, deputeti Gent Strazimiri tha se gjyqtarit në fjalë i ka mbaruar mandati si anëtar në Gjykatën e Lartë dhe se është i vetmi gjyqtar që nuk zbaton vendimet e Kushtetueses. "KPK duhet ta shkarkonte që sot (dje) Ardian Dvoranin, sepse është i vetmi gjyqtar i Republikës së Shqipërisë që nuk zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Mandati i Dvoranit si anëtar i Gjykatës së Lartë ka përfunduar katër vjet më parë dhe Gjykata Kushtetuese me një vendim të posaçëm urdhëroi mbarimin e mandatit të tij. Një vendim ky, që sot e kësaj dite nuk është zbatuar nga anëtari i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani, të cilin Edi Rama po e përgatit ta emërojë anëtar të Gjykatës Kushtetuese njësoj, si Fehmi Avdiun në vitin 1998", - u shpreh Strazimiri në një deklaratë për median. Gjithashtu, Strazimiri pohoi se Dvorani është vegël e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Dvorani, që njihet si 'çanta e shpinës' së Xhafajt u mor në mbrojtje nga KPK-ja, pavarësisht se ai nuk justifikonte 99 milionë lekë. Në një rast të paprecedent, KPK-ja përmbysi raportin e ILDKP-së me argumentin se harroi të plotësonte një fletë", tha deputeti demokrat.



Deputeti Gent Strazimiri

## Fshehën pasurinë, shkarkohen prokurori Arben Nela dhe gjyqtari Ervin Metalla

**TIRANË** - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar dje prokurorin e Tiranës, Arben Nela, njëherësh kandidat edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Sipas KPK, Nela ka fshehur pasurinë, pasi nuk ka burime të mjaftueshme financiare për ta justifikuar atë. Ndërkohë, prokurori Nela theksoi se ILDKPI ka interpretuar qëllimisht pasuritë e tij, pasi ai nuk e kishte fshehur atë. Të njëjtin fat pati edhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Tiranës, Ervin Metalla, i cili zgjodhi të mos ishte i pranishëm në sallë. Nga hetimet e KPK-së, gjyqtari ka pasur probleme me një kredi që e kishte marrë për apartament dhe më pas e kishte kaluar atë në emër të vëllait të tij, për të përfituar një kredi të butë.



Arben Nela

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



## Ministrja e Drejtësisë në Kuvend: Vetingu, proces i pakthyeshëm

# Etilda Gjonaj: Kundërshtarët e reformës në drejtësi, të destinuar të dështojnë

**TIRANE** - Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, deklaroi dje në Kuvend se "reforma në drejtësi ka nevojë për kohën e saj për t'u kryer, por vonesat në ngritjen e organeve të reja nuk kanë ardhur si pasojë e këtij procesi". "Jam e bindur se disa prej jush kurrsesi nuk e kishin menduar se do të shkatërrohej në këtë mënyrë kontrolli dhe pushteti që kishin mbi sistemin gjyqësor. Prandaj, sot jo pak deputetë prej opozitës, por jo vetëm, janë kundër këtij projektligji dhe kundër reformës në drejtësi dhe po përpiqen të ruajnë fijet e errëta që garantojnë kontrollin mbi sistemin e drejtësisë. Prandaj shpresojnë që reforma në drejtësi do të dështojë", - tha Gjonaj. "Por - theksoi ajo - reforma në drejtësi, procesi i vetingut, është një proces i pakthyeshëm. Kundërshtarët e reformës janë të destinuar të dështojnë. Kundërshtarët e reformës nuk janë as të pakë në numër dhe as të pafuqishëm dhe e dërguan dy herë ligjin në Gjykatën Kushtetuese dhe sollën pezullimin e saj dhe këta kundërshtarë vonuan në kohë votimin e anëtarëve të organeve të vetingut dhe pati shtyrje në kohë të fillimit të funksionimit të këtyre organeve". "Kjo vonesë për ngritjen e këtyre organeve të drejtësisë ka sjellë nevojën për këtë nismë. Kjo nismë legjislative jep mundësinë për të rivendosur në afat zbatimin e reformës në drejtësi dhe garantimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm për qytetarët shqiptarë", - tha Gjonaj. Ministrja e Drejtësisë i bëri këto deklarata ndërsa diskutoi në Kuvend në lidhje me ligjin për magjistratët, ligj i cili nuk mundi të kalojë për shkak të mungesës së 84 votave.



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

**DEKLARATA**

"Jam e bindur se disa prej jush kurrsesi nuk e kishin menduar se do të shkatërrohej në këtë mënyrë kontrolli dhe pushteti që kishin mbi sistemin gjyqësor. Prandaj, sot jo pak deputetë prej opozitës, por jo vetëm, janë kundër këtij projektligji dhe kundër reformës në drejtësi dhe po përpiqen të ruajnë fijet e errëta që garantojnë kontrollin mbi sistemin e drejtësisë. Prandaj shpresojnë që reforma në drejtësi do të dështojë", - tha Gjonaj.

## Ish-Prokurori i Përgjithshëm dyshohet për pastrim parash, i shpëtoi procesit të vetingut në qershor

# Krimet e Rënda sekuestrojnë pronat e Adriatik Llallës

## *Mijëra $m^2$ tokë në Tiranë e apartamenti në Durrës, me vlerë afro 1 miliard lekë*

**TIRANË**

Gjykata e shkallës së Parë të Krimeve të Rënda në Tiranë me kërkesë të prokurorisë ka vendosur sekuestro preventive mbi disa pasuri të ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. 22 mijë e 50 m2 tokë dhe një apartament banimi në Durrës janë bllokuar me argumentin se janë produkt i aktiviteteve kriminale. Burime zyrtare nga organi i akuzës dje bënë me dije se pasuria e sekuestruar e Llallës kap vlerën e rreth 1 miliard lekëve. (98.772.000 lekë). Vendimi në fjalë vjen pasi Llalla po hetohet për pastrim parash. Afro një muaj më parë, Adriatik Llalla i shpëtoi procesit të vetingut. Komisioni i Posaçëm i Apelimit në datën 11 qershor vendosi ndërprerjen e procesit për ish-drejtuesin e akuzës shqiptare, pasi kishte dhënë dorëheqjen. Llalla drejtoi Prokurorinë shqiptare nga shtatori i vitit 2012 deri në dhjetor të 2017-ës, kur u zëvendësua nga Arta Marku. Është hera e parë në historinë e Shqipërisë që një ish-Prokuror i Përgjithshëm vihet nën hetim për akuzën e rëndë të pastrimit të parave dhe i sekuestrohet pasuria. Akuza në fjalë ishte pothuajse e paralajmëruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, kur e motivoi futjen e familjes Llalla në listën e saj të zezë, duke mos i lejuar të udhëtojnë drejt SHBA-ve, me pretendimin për përfshirje në raste të mëdha korrupsioni të ish-kryeprokurorit, gjatë kohës që ka qenë në këtë detyrë.



Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla

**PASURITE NËN SEKUESTRO**

- Apartament banimi me sipërfaqe 67.2 $m^2$, ndodhur në Durrës.
- Tokë arë, me sipërfaqe 4.500 $m^2$, ndodhur në Tiranë.
- Tokë arë, me sipërfaqe 12.300 $m^2$, ndodhur në Tiranë.
- Tokë arë, me sipërfaqe 3000 $m^2$, ndodhur në Tiranë.
- Tokë arë, me sipërfaqe 2250 $m^2$, ndodhur në Tiranë.

**AKUZAT**

Çështja penale kundër ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla nisi fillimisht nga Prokuroria e Durrësit për katër akuza. Ndërsa tani po hetohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Konkretisht, ai po hetohet për veprat penale: "Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave private të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Mosdeklarimit të shumave të të hollave në kufi", "Pastrimit të produkteve të veprës penale" dhe "Shpërdorimit të detyrës".

**NJOFTIMI I PROKURORISE**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë mbi bazën e akteve të ardhura për kompetencë lëndore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr.65 viti 2018, në ngarkim të shtetasit Adriatik Llalla, ish-Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të hetimeve paraprake të kryera lidhur me këtë procedim penal, në bashkëpunim të ngushtë me policinë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore Qendrore, pranë Departamentit të Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Si rezultat i veprimeve hetimore të kryera janë krijuar dyshime të arsyeshme se disa pasuri të paluajtshme në zotërim të shtetasit Adriatik Llalla përbëjnë produkt të veprës penale.

Me vendimin nr.179, datë 20.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorisë, vendosja e masës së sigurimit pasurore "sekuestro preventive" për pasuritë e paluajtshme të mëposhtme:

Apartament banimi, me sipërfaqe 67.2 $m^2$, ndodhur në Durrës.

Tokë arë, me sipërfaqe 4.500 $m^2$, ndodhur në Tiranë.

Tokë arë, me sipërfaqe 12.300 $m^2$, ndodhur në Tiranë.

Tokë arë, me sipërfaqe 3000 $m^2$, ndodhur në Tiranë.

Tokë arë, me sipërfaqe 2250 $m^2$, ndodhur në Tiranë.

Policia Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë në datën 23.07.2018 ka ekzekutuar vendimin gjyqësor për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme të mësipërme. Vlera e tregut e pasurive të paluajtshme të mësipërme në total është në shumën 98.772.000 lekë. Vijojnë hetimet e mëtejshme lidhur me këtë procedim penal në bashkëpunim me policinë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë.

# REFORMA NË DREJTËSI
## PARLAMENTI



Seanca e djeshme parlamentare

Zv.kryetari i LSI, kërkesë Kuvendit: Jo pushime, të zgjidhim çështjen e Kushtetueses

# Rama: Dialog i partive parlamentare, për zbatimin e reformës në drejtësi

## "Nuk jemi kundër vetingut, sistemi i drejtësisë në kolaps"

Darina Tanushi

Lëvizja Socialiste për Integrim i kërkoi mazhorancës të mos i mbyllë punimet e sesionit parlamentar pa u zgjidhur ngërçi në Gjykatën Kushtetuese. Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama iu drejtua kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi, dje në seancë me fjalët: "Reforma në drejtësi duhej bërë dhe duhet bërë në frymën e bazës që ne sanksionuam me frymën e ndryshimeve kushtetuese. Pas dy vitesh Shqipëria është i vetmi vend pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë. Kjo tregon se projeksioni që u ndërtua, reforma në drejtësi ka qenë më e pakta me defekte që vijnë dhe na shfaqen deri në këtë gjendje që ne jemi sot. Përgjegjësia bie mbi të gjithë klasën politike". "Gjykoj dhe insistoj se është i nevojshëm takimi dhe dialogu i të gjithë aktorëve parlamentarë në këtë moment. Kërkoj të investoheni ju si kryetar Kuvendi që të zgjidhet problemi i implementimit të reformës në drejtësi", iu drejtua dje Luan Rama, kreut të Kuvendit, Ruçi. Më pas edhe jashtë sallës së Kuvendit, Luan Rama ka shpjeguar arsyet e kërkesës së tij, drejtuar mazhorancës, për dialog, në mënyrë që t'i jepet zgjidhje ngërçit që është krijuar në institucionet e drejtësisë. Në një deklaratë për mediat, ai tha se kjo kërkesë, në emër të LSI, është një shenjë përgjegjësie për t'iu përgjigjur interesit të qytetarëve shqiptarë. "Natyrisht, mazhoranca zgjodhi që të shkojë me pushime, punë e saj, por unë vazhdoj ta konsideroj absurde dhe papërgjegjshmëri të plotë të shkosh me pushime kur sistemi i drejtësisë është në kolaps, që do të sjell pasoja edhe më të rënda në ditët në vijim, jo vetëm për sistemin e drejtësisë, por për standardet e drejtësisë në Shqipëri dhe gjithashtu do të krijojë komplikacione edhe më të rënda për vetë funksionimin e institucioneve shtetërore", tha deputeti Luan Rama. "Kam qenë gjatë gjithë ditës në kontakt të vazhdueshëm dhe në përpjekje për të mundur të mbërrinim në një zgjidhje me kryetarin e Kuvendit, me kryetarin e grupit parlamentar të PS-së, me kryetarin e Partisë Demokratike, por në mënyrë absurde, provokative dhe me një gjuhë aspak të denjë u shfaq në këtë skenë të teatrit politik edhe Ulsi Manja, i cili na u prezantua sot edhe si specialist i kapsllëkut", u shpreh Luan Rama, duke treguar se ka pasur negociata mes palëve për të arritur në një pikë të përbashkët. Sipas tij, Manja provokoi këtë përpjekje për të gjetur një zgjidhje. "Deklaratat provokuese dhe gjuha arrogante, natyrisht nuk i shërbejnë interesit publik, interesit qytetar dhe interesit të jetësimit, ashtu siç është nisur në fakt reforma në drejtësi. Askush nuk është kundër reformës në drejtësi dhe kjo është e gjitha një spekulim i madh. Askush nuk është kundër vetingut dhe në mënyrë të veçantë, LSI e ka demonstruar këtë me qëndrimet e veta konsekuente, transparente dhe institucionale, por ta keqinformosh dhe ta keqpërdorësh shqetësimin për të zgjidhur një problem që është i madh, që është një problem në kushtet e një emergjence kombëtare, siç është mosfunksionimi i një mori institucionesh të reformës në drejtësi dhe ta fshehësh këtë prapa spekulimit se këta duan të ishte Gjykata Kushtetuese apo Gjykata e Lartë, kjo është jo vetëm spekulative, por është shqip fare poshtërsi", theksoi Luan Rama. "Unë nuk e paragjykoj dialogun dhe as nuk i trembem, e as nuk kompleksohem prej askujt që më vjen përballë në dialog institucional, kushtetues, transparent dhe ligjor. Natyrisht, mazhoranca zgjodhi që të shkojë me pushime, punë e saj, por unë vazhdoj ta konsideroj absurde dhe papërgjegjshmëri të plotë të shkosh me pushime kur sistemi i Drejtësisë është në kolaps, kolaps, që do të sjellë pasoja edhe më të rënda në ditët në vijim, jo vetëm për sistemin e drejtësisë, por për standardet e drejtësisë në Shqipëri dhe gjithashtu do të krijojë komplikacione edhe më të rënda për vetë funksionimin e institucioneve shtetërore", deklaroi Luan Rama.




Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama

**SHEZAI RROKAJ**
Deputeti i LSI, Shezai Rrokaj është shprehur se, "opozita nuk bëhet vegël në duart e pushtetit që ka kapur shtetin". Në një reagim të bërë në faqen e tij të "Facebook", ai shkruan se ligji i Magjistraturës ishte hapi i radhës për institucionalizimin e pushtetit të mazhorancës dhe kapjes së shtetit.

**OPOZITA**
I pyetur në lidhje me deklaratat e kreut të PD-së, Basha, sa u takon mendimeve që ndajnë si parti të opozitës, Luan Rama tha: "Nuk ndajmë asgjë ndryshe jo vetëm me z.Basha, por me të gjithë frontin opozitar dhe me shumicën e qytetarëve shqiptarë, kur është fjala për funksionimin e shtetit të së drejtës, për zbatimin e ligjit dhe për të ndarë përfundimisht kapjen politike që i është bërë sistemit të drejtësisë".

### Kreu i Komisionit të Ligjeve u përgjigjet kritikave të LSI

## Manja: S'ka dialog për të zhbërë reformën, opozita të reflektojë



Kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja i është përgjigjur nga jashtë Kuvendit, shqetësimit të ngritur nga zv.kryetari i LSI-së, Luan Rama. Manja ka thënë se sistemi i drejtësisë nuk është në kolaps, pasi sipas tij, reforma dhe ligjet e saj i kanë të përcaktuara rrugët e zhbllokimit të ngërçeve si në Gjykatën Kushtetuese, edhe në emërimin e magjistratëve të rinj. "Projektligj tejet i rëndësishëm i karakterit juridik, është votuar një herë në mandatin që iku bashkë me LSI. Meqë dy organe s'janë krijuar për të bërë emërimin e magjistratëve, propozimi ynë sot është që ta bëjë direk ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne s'i kemi këto vota, por ta shohim njëri-tjetrin në sy e të themi disa të vërteta për reformën në drejtësi dhe zbatimin e saj. Nuk është kuptuar procesi siç duhet. Po spekulohet politikisht", u shpreh Manja. "Njerëzit pyesin pse opozita s'voton, teoria është e qartë. Teoria e kolapsimit të reformës në drejtësi nuk është teori juridike. Është teori e opozitës, që ditën e parë pas votimit u bë pishman. Nga opozita na kanë dalë profetë juridikë që thonë se e kishin parashikuar si do kolapsohej reforma në drejtësi". Sipas tij, "dialog për të zhbërë reformën në drejtësi dijeni se s'ka e s'do të ketë. Nëse opozita s'jep votën, do presim me qetësi ngritjen e organizmave të re. Opozita të reflektojë. Konsensusi i korrikut 2016, do iu duket dimër. Ky s'është shantazh", theksoi Ulsi Manja.



### Mazhoranca do marrë mendimin e 'Venecias'

## Të larguarit nga vetingu avokatë, Braho e Xhina kundër votimit të PS

Një ndër projektligjet që miratoi sot Kuvendi ishte edhe ai për avokatinë. Projektligji "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" u miratua me 75 vota, sipas propozimit të Ballës, që të përjashtuarit nga sistemi i drejtësisë, gjyqtarë dhe prokurorë nuk mund të bëhen avokatë, ndryshe nga sa propozoi Komisioni i Ligjeve. Në seancë, kryetari i grupit të PS, Balla u shpreh se do i drejtohen me një shkresë edhe Komisionit të Venecias, nëse shkelen të drejtat e njeriut pas vendimit për të përjashtuar të përjashtuarit nga vetingu. Ndërkohë që kundër përjashtimit votuan Spartak Braho dhe Elena Xhina. "Edhe ligji që votuam për avokatinë dhe amendamenti i propozuar nga unë dhe Manja është hap i rëndësishëm drejt garantimit të moralit dhe pastërtisë së atyre. Amendamenti garanton që personat që kanë qenë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe largohen nga vetingu për një kohë të caktuar nuk mund të punojnë si avokatë. Do të marrim në kohë edhe një vlerësim nga Komisioni i Venecias", u shpreh dje Balla. Në seancën e fundit të Kuvendit u votuan me 76 vota pro dy projektvendime "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe projektvendim "Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të posaçëm të Reformës Zgjedhore". Gjithashtu, edhe projektrezoluta "Për reformën e politikës shtetërore për diasporën" dhe projektligji "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", u votuan me 76 vota pro.



Kuvendi merr zyrtarisht pushimet, ligjet me 84 vota shtyhen për në shtator

# Negociatat për magjistratët, Gramoz Ruçi: PD refuzoi të ulet në dialog

## *Kreu i Kuvendit: Gati të mbledh Kuvendin edhe në gusht*

Darina Tanushi

Kuvendi mbylli dje seancën e fundit të këtij sesioni parlamentar, duke mos arritur konsensusin për ligjin për magjistraturën. Në mungesë të 84 votave, pavarësisht tentativave për të gjetur një mënyrë dialogu gjatë ditës së djeshme, ky ligj u shty për në shtator, me shpresën e zgjidhjes. Partia Demokratike bojkotoi seancën e fundit, ndërsa LSI ishte e pranishme për disa minuta gjatë të cilave Luan Rama kërkoi negociata për një zgjidhje, duke evidentuar se drejtësia është në kolaps. Me sallën gjysmë bosh, mazhoranca votoi të gjitha projektligjet e tjera në rendin e ditës, katër ligje, pesë marrëveshje, dy projektvendime dhe një projektrezolutë. Veç magjistratëve, mbeti edhe projektligji për Kodin Rrugor, i cili gjithashtu kërkonte 84 vota për t'u miratuar. Në nisje të punimeve të seancës së djeshme, e mori fjalën zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama, i cili deklaroi se LSI nuk do të votojë ligjin për magjistratët, pasi bie në kundërshtimin me Kushtetutën e re që Kuvendi votoi dy vite më parë. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi në qëndrimin e tij ndaj kërkesës së LSI për dialogun për projektligjet, miratimi i të cilave kërkon shumicë të cilësuar, u shpreh se: "Unë, siç e kam deklaruar edhe herë të tjera, inkurajoj dhe mbështes dialogun për të kapërcyer mbi luftën politike të ditës dhe agjendës normale politike të partive politike. Sigurisht, që kemi gjëra që na ndajnë, por kemi plot gjëra që na bashkojnë, siç është reforma në drejtësi dhe unë e përgëzoj grupin parlamentar të LSI-së, që është i gatshëm për dialog. Sigurisht, unë e kam inkurajuar dhe përsëri jam në dispozicion të funksionimit të dialogut. Prandaj kërkoj që shërbimet e Kuvendit, mundësisht të komunikojnë edhe me kryetarin e grupit parlamentar të PD-së dhe në një moment, gjatë zhvillimit të seancës, të ulemi për të diskutuar të dyja projektligjet e përfshira në rendin e ditës që kërkojnë shumicë të cilësuar. Do të mbështes gjithashtu edhe propozimin tjetër, pavarësisht nga vakanca e drejtë e lejes në muajin gusht, nëse do të duhet për t'u thirrur Kuvendi për t'i hapur rrugë votimit të kandidatëve që vijnë nga institucionet e tjera si Presidenti apo Kuvendi, për Gjykatën Kushtetuese dhe për Gjykatën e Lartë. Besoj se shpreh edhe vullnetin e të gjithë deputetëve, për thirrjen në çdo kohë të Kuvendit për këtë çështje", theksoi kryetari i Kuvendit, Ruçi. Edhe në përfundim të seancës që u zhvillua pa opozitën, Ruçi bëri me dije se: "Përsa u përket propozimeve të bëra nga ana e Lëvizjes Socialiste për Integrim për dy projektligjet që kemi sot në seancë plenare, inkurajoj plotësisht dialogun ndërmjet grupeve parlamentare, me qëllimin e mirë për të mundësuar votimin e dy projektligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, si për zgjidhjen përfundimisht të ngërçit për Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe për votimin e nismës së deputetit Ndreu për Kodin Rrugor, për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve". Ruçi ndërpreu drejtimin e seancës plenare për të negociuar me tri grupet parlamentare. "Komunikova me tre kryetarët e grupeve, por kjo tryezë nuk u mundësua sepse disponibël për të negociuar ishte vetëm kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste z. Balla. Z. Spaho, pas negociatave, refuzoi pjesëmarrjen me argumentin se nuk marrim pjesë në tryezë pa u anuluar ligji për Teatrin. Z. Rama, i cili ishte propozuesi, pasi negocioi me grupimin më të madh opozitar, Partinë Demokratike, nuk mundësoi prezencën e tij në tryezë. Kështu që të dyja projektligjet, pavarësisht nga diskutimi, shtyhen deri në arritjen e një vullneti politik për t'i votuar ato me shumicë të cilësuar", bëri të ditur Ruçi.



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

**BISEDIMET**

"Komunikova me tre kryetarët e grupeve, por kjo tryezë nuk u mundësua, sepse disponibël për të negociuar ishte vetëm kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, z. Balla. Z. Spaho pas negociatave, refuzoi pjesëmarrjen me argumentin se nuk marrim pjesë në tryezë pa u anuluar ligji për Teatrin", tha dje Ruçi.

**REFORMA ZGJEDHORE**

Në seancën e fundit të këtij sesioni, Kuvendi vendosi të shtyjë edhe me 6 muaj të tjerë afatin e punës së komisionit të posaçëm parlamentar për ndryshimin e ligjit të zgjedhjeve. Ky komision bashkëdrejtohet nga dy partitë më të mëdha dhe deri tani ka punuar në heshtje për të plotësuar rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Të dyja palët kanë konfirmuar se po punojnë mbi një draft të përbashkët.

### Kreu i Kuvendit, letër presidentit për KED

## Meta i përgjigjet Ruçit: Shorti për Këshillin e Emërimit nuk rihidhet



Situata e krijuar në sistemin e drejtësisë, që është pothuajse i gjithi në kolaps, ka bërë që kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, t'i drejtohet me një letër zyrtare Presidentit Meta, duke i kërkuar këtij të fundit që të rihedhë shortin për vendet e mbetura vakante në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ruçi ka kërkuar të zgjidhë ngërçin e krijuar prej disa kohësh me këtë institucion, i cili nuk është mbledhur pasi një pjese e anëtarëve ende nuk kanë kaluar procesin e vetingut. "Vizion Plus" mëson se kreu i shtetit i është përgjigjur letrës se kreut të Kuvendit, duke i bërë me dije se shorti nuk mund të hidhet tani dhe se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka shumicën për të vendosur, pasi nga 9 anëtarë, 6 prej tyre janë ende në detyrë. Por nga lista e anëtarëve të KED, atyre në detyrë dhe atyre zëvendësues, 6 gjyqtarë ende nuk kanë dalë përpara Komisionit të Vetingut, ndërsa me shumë gjasa Rovena Gashi pritet që t'i bashkohet listës së prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk e kalojnë këtë proces. Vetëm 2 nga anëtarët e zgjedhur kanë arritur të kalojnë me sukses procesin e vetingut, po kaq është dhe numri i atyre që janë larguar.



## Magjistratët, Balla-opozitës: Jemi vonë, por jo aq për të përmbushur afatet

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla foli dje për negociata të dështuara me opozitën për të miratuar projektligjin për magjistratët. "Me gjithë përpjekjen tonë dhe dakordësinë lidhur me propozimin që bëri Luan Rama për të pasur një dialog në lidhje me rindryshimin e afatit sa i përket projektligjit të magjistraturës, dua të them se kemi pasur një komunikim me opozitën. Nuk e kuptojmë bojkotin e opozitës në votim", - tha Taulant Balla. Teksa u pyet për faktin nëse mazhoranca do të pranojë 7 pikat që përmendi kreu i PD-së, Lulzim Basha për konsensus mes palëve, Balla tha se deputetët e opozitës e kishin bërë të qartë se nuk do të merrnin pjesë, nëse nuk rishikohej ligji për teatrin. "Unë nuk shoh një lidhje mes këtyre të dyjave, mes shkollës së Magjistraturës dhe ndërprerjes së karrierës për nxënësit ekselentë. Prej ditës së parë, prej shtatorit të 2017-ës kemi shprehur gatishmërinë tonë për dialog. Opozitës i them sot zyrtarisht që jemi vonë, por jo shumë vonë për të përmbushur afatet", tha Balla. Ndërkohë që edhe në mbyllje të seancës, Balla u shpreh: "Ky nuk është një problem i pazgjidhshëm, sepse të gjithë e dimë që shumë shpejt, qoftë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, apo edhe Këshilli i Lartë i Gjyqësorit apo dhe ai i Prokurorisë do të jenë funksionalë dhe do të jetë KLGJ-ja, e cila do të përcaktojë pastaj se cila është nevoja e numrit të pranimeve në Shkollën e Magjistraturës për magjistratë gjyqësor apo kush do të jetë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, numri i nevojave që ka institucioni i Prokurorisë për prokurorë të rinj, pra që mbarojnë Magjistraturën dhe hyjnë në sistem. Kështu që sot unë ende nuk gjej një shpjegim për arsyen e vërtetë të bojkotit nga ana e opozitës në votim", tha Balla.

### Reagon kreu i grupit të LSI, Vasili: Humor idiot, dizastër

# Vetingu, Rama: Fletërrufetë, dëshpërimi i atyre që e mbushën me llum Drejtësinë



Kryeministri Edi Rama

Vetingu po vepron në pavarësi të plotë e monitorim ndërkombëtar", - deklaroi dje, kryeministri Edi Rama në një reagim në rrjetet sociale. Në reagim edhe të vendimeve më të fundit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe qëndrimit të opozitës, Rama thekson se, "fletërrufetë kundër vetingut janë dëshpërimi i atyre që e mbushën me llum Pallatin e Drejtësisë". "Loja mbaroi. Gjykatat e sipërme do pastrohen deri në fund e do ringrihen për ta bërë më në fund drejtësinë drejtësi", deklaron kreu i Ekzekutivit. Pas reagimit të Ramës, kreu i grupit parlamentar të LSI-së u shpreh se kjo logjikë e kryeministrit është një "dizastër". "Ç'dizastër kjo diarreja logjike e kryeministrit për vetingun. Kryeministrit nuk i ndalon diarreja logjike kur flet për vetingun dhe drejtësinë. Ky që flet për ndërkombëtarët që ruajnë vetingun. Çfarë humori idiot! Ky, ata kandidatë që ndërkombëtarët ia refuzuan se ishin në një turp dhe pa integritet, i futi në KLGJ dhe KLP", u shpreh në një postim në "FB", kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. "Po tani pse i filloi vërtet gjithë kjo diarre? Ç'hall i madh ia shpërtheu? Ç'mik i zemrës iu prek? Ç'interes iu cenua kaq shumë? Ç'e palarë trembet se i del sheshit? Mbahu kryeministër, mblidhu dhe mos u lësho kaq fort nëpër diarre budallëku, se si çdo sëmundje, edhe diarreja t'i shkurton ditët, këmbët dhe...", shkroi dje Vasili. Edhe më herët kreu i grupit të LSI-së, Petrit Vasili, tha se mazhoranca i preu kokën drejtësisë, teksa në seancën parlamentare pritej të votohej ligji për Magjistraturën. "Rilindja i preu kokën drejtësisë dhe e la pa Gjykatat Supreme, Kushtetuese dhe të Lartë. Paketa e ndryshimeve për reformën në drejtësi dhe për ta ruajtur drejtësinë nga shkatërrimi e paraqitur nga opozita u hodh poshtë nga rilindja javë më parë në Kuvend", shkroi dje Vasili. Sipas tij, sot kjo paketë e opozitës vazhdimisht është aty si provë e fajit shumë të rëndë të mazhorancës për drejtësinë. Rilindja është fajtorja e vetme për dekapitimin e drejtësisë. Për shkak vetëm të rilindjes në vendimin për moshapjen e negociatave është kusht ngritja e Gjykatës Kushtetuese. Pa bërë Shqipërinë me Gjykatë Kushtetuese, nuk mund të hidhet asnjë hap përpara", tha Vasili.

**DEKLARATA**

"Rilindja është fajtorja e vetme për dekapitimin e drejtësisë. Për shkak vetëm të rilindjes në vendimin për moshapjen e negociatave është kusht ngritja e Gjykatës Kushtetuese. Pa bërë Shqipërinë me Gjykatë Kushtetuese, nuk mund të hidhet asnjë hap përpara", tha Vasili.

### Kreu i PD-së: Vetingu u sabotua. Diskutimet në grup, Dash Shehi: Magjistratura, "si shkolla e plepave"

# Lulzim Basha: 7 kushte për konsensus me PS

## *Propozimi i LSI për dialog? "Skena të vjetra, si ato të Sigurimit, llafe për shou"*

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha vuri dje 7 kushte për dialog me mazhorancën sa i përket ligjit për magjistraturën. Pas kërkesës për dialog të bërë nga LSI-së, Basha tha në një konferencë shtypi se nëse ka ndonjë shans për të shpëtuar reformën në drejtësi, ai është kthimi te konsensusi i 21-22 korrikut. Paralelisht me seancën plenare, kryedemokrati Lulzim Basha mblodhi grupin parlamentar, ku u vendos edhe bojkoti. Sipas burimeve nga mbledhja, Basha u ka thënë deputetëve të tij se ligji për magjistratët e rinj nuk zgjidh asgjë. Ndërkohë në konferencën për shtyp, Basha duke iu referuar një batute të Dash Shehit në mbledhjen e grupit e krahasoi shkollën e magjistraturës me "shkollën e plepave". Basha tha se, "ligji i Magjistraturës është aprovuar vetëm me votat e mazhorancës. Është aprovuar në mënyrë të tillë, që pasi ta kapte shkollën e Magjistraturës Edi Rama, asnjë parti tjetër të mos kishte mundësi t'ia hiqte nga duart dhe kjo është arsyeja pse ligji është me 3 të pestat. Pasi vuri bordin me të emëruarit e vet dhe ata emëruan emrat që dërgoi Edi Rama, tani ajo është si me thënë një shkollë partie".



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

Edhe nëse opozita vendos t'i japë votat për ligjin e magjistraturës, sipas Bashës kjo nuk e zgjidh problemin. Sipas tij, sot reforma në drejtësi është shndërruar në një kënetë. "Askush nuk flet se kush është përgjegjësi, pse jemi në këtë gjendje. Natyrisht që përgjegjësi është Edi Rama. Motivet janë të qarta. Me një reformë në drejtësi funksionale, sot Saimir Tahiri duhej të ishte në burg. Nuk do kishte gjyqtar dhe prokuror që të kishte guximin që ta mbante larg burgut, por sot ata i kontrollon Edi Rama përmes kamikazes në Prokurorinë e Përgjithshme dhe përmes kamzhikut që përdor me komisionet e vetingut, të cilat bëjnë punë selektive politike. Për të njëjtën shkelje, një gjyqtar dhe një prokuror e largojnë dhe për të njëjtën shkelje, tjetrin e mbajnë. Pse! Sepse është në listën e bardhë të Edi Ramës, jo në atë të zezën e Ramës", tha Basha. Në 7 propozimet e tij për zgjidhjen e situatës, Basha kërkoi që të zhbëhen të gjitha rregullat ligjore që janë miratuar me dyer të mbyllura të njëanshme nga ana e mazhorancës në kundërshtim me frymën e konsensusit të arritur në ndryshimet kushtetuese, në kundërshtim me vetë parashikimet e Kushtetutës. Ai kërkoi zgjidhjen e situatës së paligjshmërisë në organin e Prokurorisë, zgjidhjen e situatës së paligjshmërisë në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të jashtëm të KLGJ-së e KLP-së, duke eliminuar nga gara të gjithë kandidatët që nuk plotësonin kriteret kushtetuese ligjore apo ishin përjashtuar nga OMN-ja dhe duke përsëritur procedurën e zgjidhjes. Kreu i PD-së kërkoi edhe zgjidhjen urgjente të ngërçit të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, duke evidentuar mekanizmat e duhura kushtetuese dhe ligjore që kjo gjykatë të jetë plotësisht funksionale.

**PROPOZIMI I LSI-së**

Sa i përket propozimit të Luan Ramës për dialog dhe përgjigjes së dhënë nga Ruçi se po presin PD-në, Basha tha se, "kjo më duket pak nga ato skemat e Sigurimit, disa prej tyre ecin akoma. Kjo nuk ecën. Opozita ka një qëndrim unik për këtë çështje dhe qëndrimi është se, siç e thashë dhe herën e fundit, nuk mund të shërojmë një pacient që i janë këputur krahët dhe këmbët thjeshtë duke i fashuar plagët". "Kërkohet një ndërhyrje e thellë për t'i qëndruar besnik konsensusit të 22 korrikut dhe për të rikthyer besimin në një proces që do të merret dhe do të zgjidhë të gjashta sfidat që numërova në fillim të fjalës sime, nuk ka rrugë tjetër. Të tjerat pastaj janë llafe sa për shou, sa për të bërë lajmin e ditës, për të bërë titullin e ditës. Nesër dhe pasnesër s'e kujton askush. Këto janë themelet e krizës dhe pa zgjidhur këto sistemi i drejtësisë, sistemi kushtetues, shteti do të vazhdojë të zhytet në llumin e kënetës Rama-Xhafa. I pyetur nëse do të ulej në një tryezë sërish me Edi Ramën, Basha u shpreh: "Unë nuk kam dëgjuar asnjë propozim, as nga Rama, as nga ndokush tjetër. Sot unë kam paraqitur qëndrimet tona sa i përket kolapsit në reformën e drejtësisë dhe zgjidhja e këtij kolapsi kërkon vullnet politik dhe besueshmëri".

**KUSHTET E KREUT TË PD-SË, DREJTUAR MAZHORANCËS**

**1.** Të zhbëhen të gjitha ligjet që janë miratuar në mënyrë të njëanshme për reformën në drejtësi.

**2.** Zgjidhje e situatës së paligjshmërisë në organin e Prokurorisë, duke i dhënë fund kapjes politike të Prokurorit të Përgjithshëm.

**3.** Zgjidhje e situatës së paligjshmërisë në përzgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të KLP dhe KLGJ, duke futur në garë të gjithë kandidatët që ishin përjashtuar nga ONM.

**4.** Zgjidhja urgjente e ngërçit të krijuar në Gjykatën Kushtetuese. Sa kohë që vendi s'ka Gjykatë Kushtetuese, vendi është në një situatë grushti shteti.

**6.** Ecuria normale sipas Kushtetutës dhe ligjeve i procesit të vetingut. Ndërprerja e menjëhershme e ndërhyrjes së mazhorancës në proces. Sot për të njëjtën shkelje dikush mbahet në detyrë, e dikush shkarkohet nga detyra.

**7.** Komision koordinimi që e përcakton edhe Kushtetuta që të jetë i balancuar dhe i paanshëm, që të mbikëqyrë ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Shoqëria përmbarimore "BAILIFF SERVICE E. HOXHA" shpk** njofton shpalljen e ankandit të III-të, për shitjen e pasurive të llojit:
- **Arë**, me sip.1,400 m², zk 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meka. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **564,480 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katëqind e tetëdhjetë) Lekë.**
- **Arë**, me sip.1,485 m², zk 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meka. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **598,752 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **24.07.2018**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë Përmbarimore "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" shpk, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 0682029920, email: elvinth@hotmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

**Më datë 17 gusht 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 t**ek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trualli që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshje sipërmarrje.
**Prona është e vëllezërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta**
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë **54150000 lek.**
Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.
Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbarimore 10% të çmimit fillestar.

**Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000**
**E-mail: best.2010@permbarues.al, web: www.permbarues.al**

**Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C**

*-"Apartament", me sip. 69.2 m2, Nr pasurie 10/158+2-1, te ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8631, Vol. 9, Faqe 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1. Prona eshte e regjistruar prane Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Lulzim Kros Beqiri . Çmimi fillestar per shitje eshte 3.100.000 Leke.*
***Data e shpalljes 05.07.2018***
***Data e zhvillimit 31.07.2018 deri ne oren 16.00***
*Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.*

Botohet në Fletoren Zyrtare regjistri i vendimeve për vitet 1993-2000

# ATP: Lista e re me 200 pronarët që marrin paratë

## *Përfituesve u është njohur e drejta për kompensim*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar vlerësimet financiare edhe për 200 dosje pronarësh. Lista është botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe përmban të dhënat e plota mbi çdo dosje. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, ka njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për dosjet e viteve 1993-2000. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim, jepen të detajuara për çdo dosje.

**APLIKIMI PËR KOMPENSIM**

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP nëntë dokumente për të marrë 20 % të vlerës së pronës në para dhe 80 % kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në agjenci për të dorëzuar: kërkesë për kompensim; konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim); dëshmi trashëgimie; prokurë; deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar; deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar; vërtetim për numrin e llogarisë bankare; dokument identifikimi dhe mandat pagese. Ndërkohë pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin duhet të brenda 30 ditëve nga data e publikimit të listës të ankimojnë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

### PRONARËT QË MARRIN PARATË

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Ibrahim Dibra | -68,197,815 |
| Durrës | Abdulla Islam Keta | 2,541,413 |
| Fier | Ndini Ndoni | 4,734,040 |
| Tiranë | SUZI BENDO | 69,848,667 |
| Fier | Mustafa Bozgo | |
| Fier | Kozma Rista | |
| Elbasan | SKENDER BEQIRI | |
| Vlorë | Riza Taushani | -78,124,160 |
| Tiranë | REXHEP BIJA | 66,891,459 |
| Tiranë | MATA 0 | |
| Tiranë | MATA 44,045,511 | |
| Tiranë | QANI DISHNICA | 1,339,380 |
| Tiranë | Xhemal Priska | 4,748,800 |
| Durrës | Mahmut Kertusha | 1,538,735 |
| Tiranë | AGRON BOCARI | 2,437,672 |
| Gjirokastër | Kristina Kristani | 489,871 |
| Tiranë | HAXHI ETJ QOSJA | 114,367,473 |
| Tiranë | BUKURIE SHKEMBI (TOPTANI) | 134,835,385 |
| Tiranë | MAKBULE, NAIME RRAKLLI | 888,300 |
| Fier | Caush Kociu | 887,600 |
| Vlorë | Evanthi Kocaqi | -19,800,728 |
| Fier | Dritan Dimo | |
| Tiranë | SULEJMAN AVORICANI | 194,671,692 |
| Vlorë | Nuri Varfi | 2,456,800 |
| Berat | Përparim Gjergjani | 5,200,420 |
| Durrës | Shefik Deliallisi | 1,828,200 |
| Tiranë | MAHMUDE DEMA | 174,186,369 |
| Tiranë | MAHMUDE DEMA | 438,909,534 |
| Gjirokastër | Mistokli Prifti | 398,930 |
| Gjirokastër | Hafize Gjata | |
| Elbasan | BEXHET URUCI | 1,941,168 |
| Tiranë | SANIE ALLA | -256,198,650 |
| Korçë | 1,666,528 | |
| Tiranë | | |
| Fier | Pellumb Belishova | -2,133,659 |
| Korçë | keti Duro | |
| Tiranë | ROMEO TUNDO | 5,223,582 |
| Tiranë | ALFRED HOBDARI | 4,995,600 |
| Vlorë | Spiro Naqo | |
| Vlorë | Kamo Sheremeti | |
| Tiranë | HAMID DEMNERI | 3,951,171 |
| Korçë | Reiz Dervishllari | -841,840 |
| Fier | Nermin Manka | 6,525,075 |
| Korçë | Selajdin Kycyky | 577,000 |
| Korçë | Hiqmet Kycyku | 63,800 |
| Shkodër | Fahri Beci | 7,052,671 |
| Fier | Andon Naci | 8,545,272 |
| Tiranë | XHEZAIR IDRIZI | 46,141,641 |
| Korçë | Sokol Kulla | 2,153,000 |
| Tiranë | ARET PINARI | -1,681,939,049 |
| Korçë | Simo Kosho | 104,640 |
| Berat | Shefqet Ismaili | 225,442 |
| Durrës | Vogel Mallkuci | -836,490 |
| Korçë | Dhimitra Karenxha | |
| Tiranë | 13,399,058 | |
| Vlorë | Emil Shiroka | |
| Korçë | Merjeme Bashllari | 945,520 |
| Shkodër | Vitore Dema | 1,234,095 |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | -40,618,420 |
| Tiranë | ARET PINARI | -1,185,028,133 |
| Lezhë | Kol Zef Kola | |
| Shkodër | Ixhlal Sykja | 30,447,493 |
| Fier | Zonje Harunaj | 3,826,949 |
| Vlorë | Kalem Tasimi | 6,899,000 |
| Shkodër | Enrik Kole Coba | |
| Shkodër | Pjeter Pashko Coba | |
| Tiranë | SELMAN BEKA | -252,725,582 |
| Korçë | Ramadan Gallo | |
| Durrës | Dhora Koraqi | |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Tiranë | SELMAN PETRELA | 0 |
| Dibër | Muharrem Koxherri | 2,395,561 |
| Dibër | Ruzhdi Shehu | -1,403,200 |
| Tiranë | BESIM ZELIA | 11,317,761 |
| Korçë | 331,500 | |
| Tiranë | HAMID DEMNERI | 10,466,220 |
| Korçë | Spiraq Çule | 84,400 |
| Korçë | Pandi Stratoberdha | 5,600,272 |
| Korçë | Reiz Dervishllari | 4,416,711 |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | 1,031,406 |
| Korçë | Xhevriko Lamce | |
| Shkodër | Trashegimtaret Dervishi | 1,438,657 |
| Gjirokastër | Shaqir Bozgo | 9,876,872 |
| Shkodër | Zahir Hasan Lahi | 1,717,695 |
| Vlorë | Qeverim Kushta | 17,110,000 |
| Tiranë | 5,601,358 | |
| Durrës | Emin Haznedari | |
| Shkodër | Aldo Zadrima | 0 |
| Tiranë | REFIK TOPTANI | -96,176,750 |
| Shkodër | Ferit Reci | 12,638,835 |
| Shkodër | Bardhok Gjoni | 900,000 |
| Kukës | Halil Din Kadria | 468,709 |
| Berat | Bardhyl Ahmetaj | 3,171,961 |
| Tiranë | THACI 1,065,626 | |
| Tiranë | SHYQYRI MILLA | 2,983,297 |
| Dibër | Ruzhdi Shehu | -9,683,251 |
| Fier | Alqi Kusta | 4,101,672 |
| Fier | Bajram Saraci | |
| Durrës | Eqerem Kruja | 4,234,584 |
| Fier | Kozma Toska | 3,539,562 |
| Durrës | Englantina Mehmeti ( Golemi ) | -18,066,430 |
| Fier | Kozma Ndreko | 7,626,669 |
| Tiranë | ZYHDI FORTUZI | -37,345,000 |
| Tiranë | ABDULLA TAGANI | -24,238,158 |
| Tiranë | KADIA, (SUFNIQI) IBRAHIM | 5,746,545 |
| Fier | Ramazan Haxhiu | |
| Fier | Gjyle Dervishi | |
| Gjirokastër | Astrit Mezini | -44,354,580 |
| Tiranë | REXHEP RARANI | |
| Fier | Faslli Haliti | |
| Fier | Andrea Bano | |
| Fier | Panoeli Ikonomi | 6,537,429 |
| Fier | Sulejman Bejte | |
| Dibër | RAMAZAN SARACI | 927,010 |
| Durrës | Selaudin Mehmeti | |
| Elbasan | RAMAZAN KOLECI | 2,649,450 |
| Durrës | -451,886 | |
| Vlorë | Aleksandër Andoni | |
| Tiranë | 22,536,544 | |
| Korçë | Sotir Çita | 427,830 |
| Vlorë | Shaban Hania | 797,393 |
| Shkodër | Trashegimtaret Jubani | 2,482,092 |
| Berat | Zydi Stermasi | 2,430,255 |
| Korçë | Sanije Koçibelli | 2,718,227 |
| Shkodër | Mynever Kasemi | 74,030 |
| Elbasan | Rifat Leka | |
| Korçë | Gurazi Myrte | 850,611 |
| Fier | Pali Dani 10,504,456 | |
| Elbasan | -40,445,600 | |
| Berat | Abaz Osmanllari | 67,675 |
| Berat | | |
| Berat | 470,312 | |
| Korçë | Vangjel andoni | -40,339,600 |
| Gjirokastër | Hiqmet Xheko | 510,825 |
| Korçë | Bedri Berberi | 902,105 |
| Durrës | Bajram Goci | -4,531,870 |
| Durrës | Abdurrahman Trebinja | -45,446,020 |
| Tiranë | 2,048,760 | |
| Korçë | Trashegimtaret Mikerezi | 4,045,244 |
| Gjirokastër | Hasim Laro | 875,700 |
| Vlorë | Ballkëze (Bisha) | -44,601,560 |
| Vlorë | Pirro Cali | |
| Elbasan | SELIM KOKUNJA | 110,086,560 |
| Tiranë | 5,386,977 | |
| Durrës | Albert Jakova, Fatmira Mançe | - |
| 13,031,620 | | |
| Korçë | Nedime Zgjani | 6,294,600 |
| Korçë | Rako Piqoni | 2,958,462 |
| Vlorë | Hektor Dervishi | 559,153 |
| Vlorë | Fejzo Binaj | 1,521,889 |
| Lezhë | Huanito Martini | 2,188,514 |
| Korçë | Trashegimtaret Mikerezi | 3,988,818 |
| Lezhë | Pjetër Mark Lesi | 2,865,038 |
| Lezhë | Pjeter Tosi | 1,040,256 |
| Tiranë | HYSNI MULLETI | -297,008,910 |
| Vlorë | Luto Telharaj | 2,999,264 |
| Berat | Kujtim Riza Ferati | 1,117,987 |
| Tiranë | 4,219,047 | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | 8,036,280 | |
| Berat | Alush Musaj | 369,017 |
| Durrës | Ramiz Halili | 3,301,170 |
| Lezhë | Zef Lesaj | |
| Lezhë | Zef Lesaj | |
| Tiranë | SELIM LULI | 1,456,896 |
| Tiranë | SELIM BAJRAM XHAFA | 11,081,880 |
| Vlorë | Kudret Zanko | |
| Vlorë | Ismail Risilia | 4,800,000 |
| Tiranë | BEDRI LIÇI | 303,646 |
| Korçë | Hatixhe Progri | 746,962 |
| Tiranë | 1,186,304 | |
| Tiranë | OSMAN MEHMET MUÇA | 123,423,867 |
| Tiranë | MITHAT PREZJA | 136,884,636 |
| Durrës | Dafina Profi | 502,223 |

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 01.08.2018, Ora 16:30**
**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "ALSION" sh.p.k:
"Njësi" me sipërfaqe 300 m2, nr.i pasurisë 15/392-N1, zona kadastrale 8523, vol. 38, faqe 4, adresa: Lagja "Syrja Dylgjeri", Elbasan.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 25 200 000 (njëzet e pesë milionë e dyqind mijë) lekë.

**Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.**

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 31.07.2018, Ora 16:00**
**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharrem Hysen Greca:
Banesë dykatëshe me sipërfaqe totale 333.16 m2, e ndodhur në zonën kadastrale 8190, Vetëdeklaruar pranë Drejtorisë së ALUIZNI Tirana Jug me nr. 428 datë 28.08.2006, adresa: Rruga "3 Vëllezërit Kondi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 4 311 075 (katër milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
**Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.**

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 01.08.2018, Ora 16:00**
**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "VIGAND Konstruksion" sh.p.k:
"Njësi" me sipërfaqe 265.22 m2, nr.i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresa: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 237 637 (dyqind e tridhjetë e shtatëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) EUR.
**Ankandi do t? zhvillohet n? ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.**

### Manastirliu: Ndryshimet, hapi i duhur për të forcuar masat ndaj dhunës në familje

# Ndryshon ligji, mbrojtje e menjëhershme për viktimën e dhunës

## *Nënat merren në mbrojtje së bashku me fëmijët*

Ndryshon ligji për marrjen në mbrojtje të viktimave e dhunës në familje. Dy ndryshimet kryesore janë lëshimi i urdhrit paraprak të mbrojtjes pa pritur që gjykata të japë një vendim përfundimtar dhe fakti që në rast se nëna merret në mbrojtje janë në të njëjtën masë edhe fëmijët. Ndryshimet ligjore janë bërë të ditura dje nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu. "Me urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, një element i përfshirë për herë të parë në ligjin për masat ndaj dhunës në familje, sigurohet mbrojtje e menjëhershme për viktimën e dhunës, deri në daljen e vendimit nga gjykata". Kjo është një ndër risitë që parashikon ligji i ndryshuar "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i prezantuar nga ministrja Manastirliu në Kuvend. Duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të këtij ligji, Manastirliu deklaroi nga foltorja e Kuvendit se do të garantohet mbrojtje më e mirë, sidomos për kategoritë vulnerabël. "Zbatimi i ligjit të përmirësuar do të ketë efekte të menjëhershme në parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në familje, në të gjitha format e saj, duke garantuar dhe masa të tjera të nevojshme për anëtarët e tjerë të familjes, të cilët janë viktima të dhunës, me vëmendje të veçantë te gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar",-tha Manastirliu. Ligji i ri zgjeron mbrojtjen për gratë dhe vajzat që janë viktima të dhunës. "Ky ligj për herë të parë do të veprojë edhe në rastet e dhunës në marrëdhëniet intime, jo detyrimisht të përcaktuara si lidhje gjaku apo martese, apo bashkëjetese, duke garantuar mbrojtje efikase për gratë dhe vajzat",-tha Manastirliu. Ndër risitë e tjera që parashikon ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare është edhe përmirësimi i masave mbrojtëse për fëmijët, pasi, me urdhrin e mbrojtjes për nënën, automatikisht do të garantohet urdhri i mbrojtjes për fëmijët, edhe nëse mbi ta nuk është ushtruar dhunë e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ky ligj përcakton afate të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës të urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, duke eliminuar zvarritjet e proceseve gjyqësore dhe duke siguruar më shumë mbrojtje për viktimat e dhunës. Ligji parashikon edhe detyrimin e organeve shtetërore për të ofruar falas çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje, duke filluar nga shërbimi i ekspertizës psiko-sociale, mjeko-ligjore, etj., shërbime që nuk do të ndikojnë më në proces, pasi do të ofrohen nga shteti dhe më pas fatura për këto shërbime do të jetë e dhunuesit. Efektet që sjell ky projektligj prekin jo vetëm sistemin e mbrojtjes për viktimat, por, gjithashtu, parashikohen dhe shërbime rehabilituese për dhunuesit, me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar apo me probleme të shëndetit mendor, të cilat do të jenë qartësisht të shprehura në vendimet e gjykatave për lëshim e urdhrave të mbrojtjes. Propozimet për ndryshimin e ligjit që miratohet sot kanë kaluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke u prezantuar në tryeza konsultimi me të gjithë aktorët përgjegjës. "Është një ligj që do të mbrojë më mirë palët, një ligj më mirë i përputhur me standardet ndërkombëtare, një ligj më i shpejt në veprim, një ligj më efektiv",-tha Manastirliu, duke ftuar të gjithë deputetët të votojnë ndryshimet ligjore që përmirësojnë ligjin për "Masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"



## MSH, vizita dhe syze falas në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier



Ministria e Shëndetësisë bën të ditur se pas Shtëpive të të Moshuarve në Tiranë, Kavajë, Gjirokastrës dhe Shkodër vijon nisma për vizitat e specializuara dhe syze falas për Shtëpinë e të Moshuarve në Fier. 58 të moshuar kryen vizitat e specializuara okulistike dhe u pajisën me syze të posaçme sipas nevojës. Shërbimi i plotë okulistik falas, i cili ofrohet për herë të parë në institucionet rezidenciale publike për të moshuarit do të vijojë gjatë muajit korrik në të gjitha Shtëpitë e të Moshuarve në vend. Pak ditë më parë banorët e Shtëpisë së të Moshuarve në Tiranë, të moshuarit që banojnë në qendrën rezidenciale të Kavajës, Shkodrës si dhe të Gjirokastrës përfituan vizitat e specializuara dhe syzet falas. Nisma e ministres Manastirliu do të vijojë me të gjithë të moshuarit që banojnë në institucionet publike rezidenciale.

## Veliaj: Mandatin tjetër, udhëtimi i parë me tren elektrik nga Tirana në Rinas

Brenda pak vitesh qytetarët e Tiranës do të udhëtojnë drejt aeroportit të Rinasit dhe qytetit të Durrësit me tren elektrik dhe stacioni do të jetë thuajse në të njëjtin vend ku ka qenë stacioni i vjetër. Lajmi është bërë me dije nga kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë ceremonisë së vendosjes së instalacionit të lokomotivës me avull në hyrje të Bulevardit të Ri, në shenjë simbolike, si kujtesë për ish-Stacionin e Trenit. "Treni i ri elektrik do të kalojë në anën tjetër, kjo është arsyeja pse e vendosim lokomotivën në këtë anë. Me këto mundësi, besoj se brenda mandatit tjetër do të kemi shansin që të përjetojmë udhëtimin e parë me trenin elektrik, pa ndotje, nga Tirana në Rinas dhe pastaj nga Tirana në Durrës. Do të kemi mundësi të shikojmë, ku ishim, ku jemi dhe ku duam të shkojmë në të ardhmen",- deklaroi Veliaj. Lokomotiva e vendosur në Bulevardin e Ri u prodhua në vitin 1951 në Poloni dhe përfundoi misionin e saj në vitin 1986, në Shqipëri. Fillimisht u shërbeu udhëtarëve e më pas trenave te mallrave. Më shume se një relike e fillimit hekurudhor shqiptar, lokomotiva me avull shërben edhe simbol i rrugëtimit të pandalshëm i zhvillimit të Tiranës.

**CORRECTION OF THE REQUEST FOR EXPRESSION OF INTEREST**

(published on July 19, 2018)
(CONSULTING SERVICES – INDIVIDUAL SELECTION)

**PROJECT:** Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting in Albania
**Grant No.:** TF0A3277 (Portion A); TF0A5134 (Portion B)
*Consulting Service for International Consultant*
**Assignment Tittle:** Support MOFE to lead the reform for IPSAS adoption and implementation (Preparation of an implementation plan of IAS)
**Reference No**. AL-CFCU-58021-CS-INDV

Expressions of interest (CV, Cover letter and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by fax, or by e-mail within **August 3rd, 2018, local time 12:00.**

**Mrs. Enkelejda Kokthi, General Director**
**Central Finance and Contracting Unit (CFCU)**
**Ministry of Finance and Economy**
**enkelejda.kokthi@financa.gov.al**
**cfcu.financa.gov.al**
**"Deshmoret e Kombit" Blvd. No.3, Tirana, Albania**
**Tel: + 355 4 24 51 180**

PASTIÇERIA

# "BELLA VENEZIA", aty ku pastiçerët me famë botërore përgatitën tortën e dasmës së Zogut

*Historia e Petraq Tokës dhe marrja e çmimit ndërkombëtar më 1935*

Bella Venezia" apo më vonë pastiçeri "Tirana" ishte një nga vendet më të frekuentuara në kryeqytet. Ajo drejtohej nga Petraq Toka dhe Dhimitraq Papa, bashkëpronarë në biznes dhe me lidhje familjare. I studiuar jashtë për pastiçer, Petraqi pati dhe ndihmën e familjes së të shoqes, Flora Tasellari (Toka), e cila rridhte nga familje pastiçerësh, kishte dhe të afërm që merreshin me këtë profesion. Çmimi i marrë në Bruksel, në vitin 1935, e kristalizoi pozitën e Petraqit si një ndër pastiçerët më të mirë në botë. Po kush është njeriu që përgatiti tortën me zambakë të dasmës së Mbretit Zog...

**PAK HISTORI**

Petraq Toka lindi në Melan të Përmetit në 02.02.1888, fshat që në fund të viteve '40 u braktis dhe banorët u shpërngulën kryesisht në Tiranë, por edhe në Greqi e Turqi. Familja e tij u shpërngul në Stamboll, ku punonte i ati, Apostoli, i cili kishte në pronësi toka bujqësore, në lagjen "Bajram Pasha". Aty ai kreu studimet në shkollën unike greke. Pas shkollimit Petraqi u shpërngul në Egjipt ku mbaroi një shkollë franceze pastiçerie. Aty ai u lidh me një francez, pronar i një fabrike çokollatash, të cilin e ndihmoi shumë në biznes, duke e shpëtuar nga falimentimi. Së bashku kanë punuar si ortakë, si dhe kanë fituar një çmim për zbukurimet e tortave, zbukurime me trajtë trëndafilash. Në mes të viteve '20 Petraqi u kthye në Shqipëri dhe u vendos në Tiranë së bashku me familjen, e ishte pikërisht kjo kohë kur ai hapi dhe pastiçerinë "Bella Venezia", e njohur më vonë si pastiçeri 'Tirana', që ndodhej mbrapa Muzeut Historik Kombëtar. Në fillim të viteve 30' ata hapën dhe një restorant në Tiranë, te rruga e 'Barrikadave', përpara teqesë si dhe një pastiçeri të dytë "Bella Venezia" në Durrës, te rruga e portit, me bashkëpronar kushëririn e të shoqes, Misto Tasellarin.






(Djathtas) Petraq Toka, pronari i 'BELLA VENEZIA'. (Majtas) Diploma e fituar në Bruksel si një nga pastiçerët më të mirë



Fotografia e 'Bella Venezias' në Durrës me Misto Tasellarin

**ÇMIMI E TORTA**

Në vitin 1935 themeluesit e pastiçeri "Bella Venezia" dërguan në Bruksel, në panairin ndërkombëtar të pastiçerisë, prodhimet e tyre të zakonshme në dyqan, biskota, amareta, çokollata dhe Marron glacé-në, të cilën e preferonte veçanërisht dhe ishte specialiteti i tij. Ata konkurruan me prodhimet e zakonshme të dyqanit dhe nuk përgatitën të tjera enkas për panairin. U vlerësuan nga një juri e përbërë nga 50 veta me çmim të parë dhe medalje ari për konfeteri dhe biskoteri. Ky ishte vlerësimi më i madh që mund t'i jepej pastiçerit në atë kohë. Nami i Petraqit shkoi deri te Mbreti Zog, i cili çdo porosi të tijën për ëmbëlsira e bënte të "Bella Venezia". Mbreti kishte preferenca perëndimore për ëmbëlsirat; çokollatat, biskotat, konfeteritë dhe e preferuara ishte Marron glacé-ja. Ndaj në ditën e madhe të kurorëzimit me mbretëreshën Geraldinë, i kërkoi Petraqit t'i përgatiste tortën e dasmës. Veçantia e tortës ishte se pavarësisht përmasave të saj, ishte krejtësisht me përbërës pastiçerie, dhe nuk kishte strukturë mbajtëse. Çdo pjesë e saj, qoftë edhe ato lidhëset, ishin të ngrënshme. Trashëgimtarët e familjes Toka na tregojnë fotografinë ku duket djali i madh i Petraqit, Ngjeli, asokohe gjimnazist pesëmbëdhjetëvjeçar duke qëndruar pas tortës ditën e dasmës. Ai ishte caktuar të kujdesej për mirëmbajtjen e tortës gjatë transportit duke qenë se në përpjekjet e mëparshme kjo ishte prishur dy herë, për shkak se ishte delikate pasi i mungonte struktura mbajtëse. Të tjera fotografi të asaj kohe, ku paraqitet djali i Petraqit janë dhe fotografia e tij dhe të motrës me veshje kombëtare, si dhe një fotografi e Ngjelit me kushërirën e tij me veshje kombëtare të Përmetit. Pas viteve të çlirimit Enver Hoxha sulmoi pastiçerinë "Bella Venezia", për shkak se aty mblidheshin revolucionarët. Pastiçeria është sulmuar te libri "Ditët kur lindi partia" shkruar nga vetë Hoxha. Në ato kohë familja u përball me largime nga detyra, transferime, etj. Pas luftës dyqani u shtetëzua. Drejtuesit e "Bella Venezia" dorëzuan vullnetarisht dhe pasurinë pasi ishin tregtarë të pasur. Petraqi u sëmur dhe punoi shumë pak, kurse Dhimitraq Papa, vazhdoi aktivitetin e tij te pastiçeria e hotel "Dajti". Kjo është historia e Petraq Tokës njeriut që mban mbase të vetmen medalje ndërkombëtare të këtij lloji në Shqipëri, pastiçerit që ëmbëlsonte njerëz të thjeshtë e mbretër. Re.de



Pastiçeri 'BELLA VENEZIA', që më pas u quajt 'Tirana'



Djali i Petraqit, Ngjeli me kushërirën e tij, me veshje kombëtare të Përmetit



Torta e dasmës së Zogut, përgatitur nga Petraq Toka. (Foto u pre pas revanshit komunist)



## Vjedhja e bankës në ish-Bllok, 13 vite burg për Roland Litin, 1.6 për Alan Babameton

**TIRANË** - Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës ka dhënë dje dënimin për dy autorët e vjedhjes së një banke të nivelit të dytë në zonën e ish-Bllokut, ngjarje kjo e ndodhur dy vite më parë. Roland Liti është dënuar me 13 vite burg, ndërsa për Alan Babameton është caktuar dënimi 1 vit e 6 muaj, pasi akuzohet për moskallëzim krimi. Banka e nivelit të dytë në zonën e ish-Bllokut u grabit më datë 8 gusht të 2016-ës, ku autorët mundën të merrnin rreth 190 milionë lekë të vjetra. Autorët kanë mundur të hyjnë në ambientet e një bodrumi që më parë ka shërbyer si lokal, duke thyer një dritare të vogël. Ata u tradhtuan nga shenjat e gishtërinjve që kishin lënë mbi një shishe uji, të cilën e kishin harruar në vendin e ngjarjes. Nga analizat e AND-së u bë i mundur identifikimi dhe arrestimi. Asokohe për ngjarjen në fjalë u arrestua edhe shefi i sigurisë së filialit të bankës. Fillimisht për këtë ngjarje u akuza edhe Robert Kulla, por më pas hetimet për atë u pushuan.

Medaljoni "tradhtoi" të renë. Arrestohet edhe 22-vjeçari Emiljano Grembi

# Grabitja e karburantit në Levan, 31-vjeçarja "sexy": E bëra për hakmarrje

## *"Bastisjen e bëra me kushëririn pasi festova ditëlindjen, ishim në gjendje të dehur"*

**FIER**

Gjithçka nisi si aventurë, por ishte edhe hakmarrje. Grabitjen e parë e kryem në gjendje të dehur, pasi festova ditëlindjen. Bashkë me kushëririn tim, Emiljanon shkuam te pika e karburantit në fshatin Levan, pasi disa kohë më parë, punonjësi i këtij karburanti ka gabuar me kursin e këmbimit. Edhe pse debatova me të, punonjësi nuk më ktheu reston e duhur, ndaj dhe u hakmora ndaj tij". Kështu ka deklaruar para hetuesve të çështjes, 31-vjeçarja Anna Malaj nga fshati Visokë e Mallakastrës, e cila u arrestua dy ditë më parë, pasi akuzohet se në bashkëpunim me kushëririn e saj (djalin e hallës) 22-vjeçar kanë grabitur një pikë karburanti dhe kanë tentuar që të grabisin edhe dy të tjerë. Një ditë pas arrestimit të grabitëses "sexy", policia e Fierit ka vënë në pranga edhe bashkëpunëtorin e saj, Emiljano Grembin. I riu nga fshati Belinë të Patosit u kap, pasi blutë arritën të zbardhnin dhe të dokumenton tri ngjarjet e ndodhura.

**DËSHMIA E GRABITËSES**

Në bazë të të dhënave operative, policia e Fierit ka bërë të mundur dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur në orët e para të mëngjesit të 2 korrikut të këtij viti, që çoi edhe në arrestimin e Anna Malajt dhe Emiljano Grëmbit. Dy kushërinjtë në bashkëpunim me njeri-tjetrin kanë arritur të marrin 30 mijë lekë të rinj nga një pikë karburanti. Për të dokumentuar ngjarjen dhe për ta lidhur atë edhe me tentativën e grabitjes së dy pikave të tjera të karburantit në Mallakastër e Fier është dashur sekuestrimi i kamerave të sigurisë, të cilat kanë nxjerrë në dritë të vërtetën. Ndërkohë që policia ka siguruar të dhëna operative se femra që kishte marrë pjesë në të tria grabitjet, mund të ishte 31-vjeçarja Anna Malaj, e cila më parë quhej Jonida. Pas fakteve të mbledhura, efektivët e policisë kanë shkuar për kontroll në banesën e 31-vjeçares, duke e pyetur këtë të fundit nëse kishte armë dhe Malaj ka dorëzuar menjëherë armën e gjahut që rezultoi të jetë përdorur në grabitje. Në oborrin e shtëpisë së 31-vjeçares është gjetur edhe automjeti i ngjashëm me makinën e përdorur nga grabitësit, që dukej në kamerat e sigurisë të pikave të shitjes së karburanteve. Kanë mjaftuar këto fakte për të kryer edhe shoqërimin e 31-vjeçares, të cilës i janë marrë deklarimet përkatëse lidhur me tri ngjarjet. Gjatë marrjes në pyetje, prokurori i çështjes, Çlirim Sino, ka konstatuar se 31-vjeçarja mbante në qafë një medaljon të ngjashëm me atë që mbante vajza e cila shfaqej në pamjet e sigurara nga kamerat e sigurisë. Pasi janë krahasuar të gjitha të dhënat, Anna Malajt i është kërkuar që të ecë dhe vrapojë për disa metra, duke krahasuar këtë të fundit me imazhet e marra nga kamerat e sigurisë, që përafrohej thuajse totalisht. E ndodhur përballë këtyre fakteve, ajo ka rrëfyer të vërtetën para prokurorit, duke pranuar se ishte ajo vajza që shfaqej në mjediset e karburanteve. 31-vjeçarja Malaj ka treguar përpara grupit hetimor se pasi ka festuar datëlindjen e saj të 31 më datë 1 korrik, në gjendje të dehur kanë shkuar së bashku me kushëririn, Emiljanon që të vidhnin me armë karburantin që ndodhej pranë fshatit Levan. Sipas saj, pasi kishin pirë, janë nisur për të kryer grabitjen e parë. Ajo ka shpjeguar se kanë përzgjedhur pikërisht këtë pikë shitjesh karburantesh, pasi disa kohë më parë, kur kthehej nga Vlora për në Fier, kishte ndaluar për t'u furnizuar në këtë karburant. E ndaluara ka pohuar se i ka dhënë punonjësit 50 euro për të paguar, por ky i fundit kur i ka kthyer reston, ka gabuar me kursin e këmbimit. Mësohet se 31-vjeçarja ka pohuar para hetuesve se edhe pse ka debatuar, punonjësi nuk i ka kthyer reston e duhur dhe për këtë arsye ka dashur të hakmerret ndaj tij. Ndërkaq, 31-vjeçarja ka pohuar se grabitjen e parë e kanë kryer nën efektin e pijeve alkoolike dhe se gjithçka ka nisur si një aventurë, bazuar kjo edhe në mërinë e mbajtur nga kthimi mangët të restos nga punonjësi i karburantit në Levan të Fierit, për të cilën nuk ka qenë dakord. Dhe duke lënë pas aventurën e herës së parë, për dy tentativat e tjera, 31-vjeçarja mësohet të ketë thënë se ka qenë nevoja për para, ajo që i ka shtyrë të shkojnë për të grabitur, pa ia arritur qëllimit. Autorësia e ngjarjes është pranuar edhe nga Emiljano Grëmbi, djalë i hallës së Anna Malaj, i ndaluar ditën e djeshme. Pritet që dy të rinjtë të dalin ditën para togave të zeza të Fierit për masën e sigurisë.



31-vjeçarja e arrestuar, Anna Malaj

**MEDALIONI**

Gjatë marrjes në pyetje prokurori i çështjes, Çlirim Sino, ka konstatuar se 31-vjeçarja mbante në qafë një medaljon të ngjashëm me atë që mbante vajza, e cila shfaqej në pamjet e siguruara nga kamerat e sigurisë. Pasi janë krahasuar të gjitha të dhënat, Anna Malajt i është kërkuar që të ecë dhe vrapojë për disa metra, duke krahasuar këtë të fundit me imazhet e marra nga kamerat e sigurisë, që përafrohej thuajse totalisht.

**EMILJANO GREMBI**

Duke lënë pas aventurën e herës së parë, për dy tentativat e tjera, 31-vjeçarja mësohet të ketë thënë se ka qenë nevoja për para, ajo që i ka shtyrë të shkojnë për të grabitur, pa ia arritur qëllimit. Autorësia e ngjarjes është pranuar edhe nga Emiljano Grëmbi, djalë i hallës së Anna Malajt, i ndaluar ditën e djeshme. Pritet që dy të rinjtë të dalin ditën para togave të zeza të Fierit për masën e sigurisë.




Materialet e sekuestruara nga policia

### Goditet grupi i hajdutëve, 2 në pranga dhe 1 në kërkim

**DIBËR** - Policia e Dibrës ka finalizuar me sukses operacionin e koduar "Maqellara", ndërsa në pranga kanë përfunduar dy persona dhe një tjetër është shpallur në kërkim. Sipas policisë, grupi akuzohet për një seri vjedhjesh. Mësohet se gjatë operacionit në fjalë u ndaluan shtetasit Resmi Jakimi, 31 vjeç (i dënuar më parë për vjedhje) dhe Egert Jakimi, 27 vjeç, të dy banues në Shupenzë, Bulqizë. Ndërsa është shpallur në kërkim shtetasi V.R., 24 vjeç, banues po në Shupenzë. Ndalimi i tyre dhe shpallja në kërkim e bashkëpunëtorit u bë, pasi më datën 22.07.2018, rreth orës 02:30 të natës, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur një sasi nafte prej rreth 60 litrash në fshatin Erebarë në automjetin kamion në pronësi të shtetasit E.L., si dhe kanë tentuar të vjedhin në fshatin Burim, Maqellarë, banesën e shtetasit F.L.. Policia e Dibrës menjëherë pas njoftimit të marrë për dy ngjarjet e mësipërme kanë organizuar punën, duke ngritur një pikë postblloku të befasishme, ku autorët nuk u janë bindur bluve për të ndaluar, duke u larguar me shpejtësi me një automjet tip "Benz". Nga hetimet e kryera, rezulton se pjesëtarët e këtij grupi janë autorë të dyshuar edhe të disa vjedhjeve të tjera të kryera gjatë periudhës majkorrik të këtij viti. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së Dibrës për veprat penale "Vjedhje", kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, "Vjedhje" mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe "Mosbindjes ndaj urdhrit të punonjësit të rendit publik".

## Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzojnë përfituesit

# Dosjet e viteve 1997-1998, formulari për të marrë paratë

## Lista me 3260 pronarët në të gjithë vendin

Ornela Manjani

Pronarët që aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1997 dhe 1998, për të cilët ka një vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës duhet të plotësojnë formularin-tip për të marrë paratë. Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin dhe dokumentet që duhet të plotësojnë rreth 3260 përfitues në të gjithë vendin për të marrë kompensimin në para ose kompensim fizik. Për dosjet e vitit 1887 janë 1460 pronarë dhe dosjet e vitit 1998 janë 1800 pronarë. "Gazeta Shqiptare" publikon formularin, dokumentet si dhe listën me pronarët që duhet të plotësojnë dokumentet për të përfituar kompensimin.

**KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK**

Sipas formularëve-tip mësohet se kërkuesi, duket të cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës vërtetim nga gjykata, nëse vendimi përfundimtar i apo vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

**LLOGARITJA**

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

**PAGESAT E PËRSHPEJTUARA**

Pronarët mund të përfitojnë edhe pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese, të cilat shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimeve dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

## DOSJET E VITEVE 1997-1998

**DOSJET E VITEVE 1998**
**Bashkia Emri (Subjekti Kerkues) VLERESIMI**

Korçë Ramadan Zere 600,000
Maliq Selim Selaj 649,177
Krujë
Krujë 4,126,192
Rrogozhinë XHAVID HARIZI 526,350
Tepelenë Zenel Bano 1,310,628
Tepelenë Agim Licaj 98,138
Korçë -14,476,000
Korçë Ali Çone -9,571,000
Korçë Gerti Çollaku -7,012,500
Korçë Kostika Todi -32,040,600
Durrës Riza Vogli -212,413,840
Durrës Zenepe Etemaj -9,004,664
Mat Llesh Elezi 1,717,408
Mat Mëhill Elezi 2,027,523
Fier Jakup Shahaj 2,265,769
Fier Vangjel Gjeçi 698,770
Fier Todi Peri 3,992,974
Fier Sami Fejzulla 3,130,563
Fier Shaban Pajaziti 954,643
Fier Llazar Moni 0
Fier Hava Vutha 2,146,760
Memaliaj Hajdar Sina 1,269,464
Kamëz AHMET BRAHIMAJ 380,283
Kamëz DUKA 51,920
Tiranë ILIRJAN KOÇI 378,560
Tiranë MUSTAFA GRORI 1,105,857
Vorë FATIME KALAJA 1,402,969
Tiranë XHEVDET KASHARI 556,624
Tiranë MYSLYM MALOKU 3,897,243
Vlorë Veip Jonuzi 816,000
Skrapar 1,428,362
Skrapar
Skrapar Irfan Dauti 890,100
Bulqizë IMER TAHIR LEKA 18,033
Berat Kalem Hysko 1,335,208
Memaliaj Shyqyri Ruçi 738,822
Devoll Namik Spaho 684,108
Fier Fuat Resuli -1,783,037
Fier Yzedin Resuli -124,767,936
Fier Rexhep Myrtaj 3,737,400
Mallakastër Fatime Hajro 1,892,062
Mallakastër Selam Fejzaj 687,787
Fier Sabri Resuli -2,087,263
Fier Laver Resuli
Kukës Sabrie Zylfi Onuzi 567,389
Devoll Emin Rushitaj 227,710
Maliq Kujtim Demiri 43,180
Maliq Emin Shkëmbi
Maliq Agim Ibrahim 85,400
Korçë
Lezhë Kol Gjoni
Krujë 1,399,688
Divjakë Miti Libofsha -24,700
Lushnjë Nazim Pupe 1,456,000
Lushnjë Faredin Lici 0
Mat MEXHIT HYSA 375,576
Lushnjë Et'hem Liçi
Dropull Vasil Kuruni -4,954,662
Dropull Dhimiter Gaco 0
Gjirokastër Muharrem Xhaferi 147,600
Dropull Arqile Tuni 501,892
Gjirokastër Lefter Mehmeti (Kulluci)
Dropull Spiro Veresi 368,448
Bulqizë MAHMUT SELMAN ZGURI 48,857
Dropull Evjenia Mari -211,700
Gramsh ILIRJAN SHAHINI 3,925,504
Gramsh ILIRJAN SHAHINI 5,297,958
Tepelenë Qerim Allkaj
Kolonjë Shefiko Ademi
Kolonjë Sotir Nikolla 75,072
Kolonjë Janaq Kapurani 0
Kolonjë 26,040
Kavajë SHKELQIM SHEHI 1,559,192
Rrogozhinë FIZE MUKA 2,000,129
Kavajë VLADIMIR, MARGARITA DAKA 516,848
Kavajë BISLIM KRASNIQI 302,693
Kavajë TRASHEGIMTARET E MYFTAR LEKA LEKA 1,162,624
Rrogozhinë SHAQIR DEDA -427,601
Kavajë TELHA CEMEMA 789,600
Rrogozhinë LAHI, PETRIT, KUDRET DUBALI 57,042
Kavajë VATHI KURSHUMI 97,279
Kavajë FIQIRETE GORANI (HAXHIALUSHI) 3,342,311
Rrogozhinë Shefqet Bega 2,054,204
Kavajë Muharrem Tafa 1,248,770
Kavajë Bajram Xherri 2,445,543
Rrogozhinë Vija Mihani 878,408
Kavajë Shefqet Muka
Librazhd IDRIZ QOSJA 371,130
Pogradec Tefik Duka 89,385
Pogradec Niko Naço 400,487
Pogradec Kadri Belli 79,312
Pogradec Rexhep Belliu 320,635
Pogradec Gani Ibi 106,289
Pogradec Hekuran Musaraj 370,814
Pogradec Burbuqe Nuri 325,332
Pogradec Agim Maxhari 600,229
Pogradec 93,065
Pogradec Naze Zenunllari 174,312
Pogradec Todi Llakmani 279,991
Pogradec 308,980
Pogradec Enverije Hyzenka 44,921
Pogradec 123,592
Pogradec Vera Çela 1,266
Durrës Ismail Qela 429,552
Himarë Ismet Elezi -657,600
Konispol Theodhori File 43,965
Himarë Mitro Martiko
Sarandë Mino Çipa 8,513,830
Gjirokastër Misto Puci 0
Lushnjë Selim Hoxha 10,569,184
Lushnjë Orjon Hoxha
Mallakastër Shaho Kapaj 2,105,534
Kamëz
Memaliaj Qazim Salia 166,544
Tepelenë Isuf Islami 774,168
Memaliaj Kaso Hasaj 252,623
Skrapar Bajram Guri 984,990
Skrapar Bajram Guri
Skrapar 419,681
Skrapar Bedri Omeri 1,557,391
Skrapar Bedri Omeri 387,537
Skrapar Zylyfkade Hajdari 923,909
Kuçovë Hekuran Zylyf Çilaj 0
Tepelenë Sofokli Koci 28,975
Berat Feim Ismail Ago
Fier Petraq Bare 2,728,604
Fier Mihal Gjeçi 633,822
Fier Avni MUskaj 3,448,328
Fier Vasil Ristani 3,131,778
Fier Petrit Cervenaku -1,322,762
Fier Sotir Thomai 5,609,494
Fier Haxhi Hoxha 3,156,026
Fier Bajram Gashi 1,162,929
Fier Haxhi Gashi 1,806,393
Fier Rrapo Ujaniku 2,125,815
Roskovec Kujtim Ngjeqani 143,606
Patos Ismail Myftari 2,752,598
Fier Muharrem Avdia 558,216
Fier Donika Tashi 1,181,951
Divjakë Rrapi Gjini
Sarandë Qazim Ahmeti
Roskovec Nikollaq Xhixhi 535,806
Kamëz ZEQINE BOGDANI (ZEGJINE) BOGDANI, (ZEGJINE) 1,104,661
Memaliaj 531,731
Tepelenë Selman Kazizaj 220,812
Shkodër Enver Bajraktari 244,817
Vau i Dejës Preng Mark Nikolla 14,970
Vau i Dejës Ragip Beshtriku 825,780
Vau i Dejës Kol Ndue Caka 122,803
Rrogozhinë OSMAN SARACI 1,965,270
Kavajë Dervish Haka, Zyme Haka 3,290,000
Kavajë MUSTAFA SHEHU 5,038,123
Kavajë MEHMET RROKJA 24,427,730
Vorë SAID BURAJ
Tiranë IBRAHIM HASA 594,000
Tiranë OSMAN HOXHA -30,448,360
Kavajë Qani Isufi -15,730,280
Shkodër Lodovik Kiri 162,983
Skrapar Shyqyri Turhani 1,106,095
Skrapar Riza Abazi
Skrapar Riza Abazi 792,504
Skrapar Qani Musabelliu
Skrapar Qani Musabelliu 392,381
Skrapar Hajrulla Pelivani
Bulqizë ADEM GANI JELLA 26,412
Memaliaj Alem Kanani 1,853,929
Bulqizë RUSTEM ÇERENI 2,621
Memaliaj 713,050
Tepelenë Pasho Ruci
Këlcyrë Adem Hoxhallari 21,816,365
Dropull Vangjel Kaci -1,938,744
Kolonjë Amalia Gërmenji
Këlcyrë Veiz Hasan (Alizoti) 832,394
Këlcyrë Shefqet Kule 406,256
Gjirokastër Sevo Doku
Gjirokastër Alush Azati -2,213,620
Këlcyrë Haxhi Haxhiaj 1,802,030
Këlcyrë Bajame Kule 360,165
Këlcyrë Safet Kule 291,246
Këlcyrë Neki Hyseni 456,630
Këlcyrë Gezim Kule 106,980
Këlcyrë Metushe Lutaj 298,479
Kolonjë Mantho Thomollari
Këlcyrë 902,006
Memaliaj Hetem Ismail Mehmeti 748,363
Elbasan SAMI PRECI 41,095
Berat 1,727,817
Ura Vajgurore Nasi Gori Pleqi 1,141,483
Ura Vajgurore Nefki Ali Braho 448,203
Kuçovë Zenun Rexhep Agalliu 3,329,829
Dibër EMRULLA LUSHA -8,123,808
Kuçovë Veiz Bejdo 1,969,979
Fushë Arrëz Idriz Beqir Sadria 0
Vau i Dejës Simon Xhanaj 5,571,448
Ura Vajgurore Trifon Simon Ziu 1,945,834
Ura Vajgurore Llukan Tili Shkembi 4,028,900
Himarë Diana Bilali 18,064
Konispol Izet Shaqiri 2,787,006
Konispol Shaban Hania 797,393
Himarë Llambro Nika 38,097
Poliçan Llazar Mihal Stajko 909,295
Berat Naftali Pjeter Laçka 537,843
Kuçovë Islam Ramadan Xhafa 1,813,184
Poliçan Dane Dine Molla 290,049
Peqin MUSTAFA GODELLI -28,429,346
Memaliaj Shaban Hazbi Bakaj 696,751
Memaliaj Albert Demir Malkaj 215,198
Kurbin Zef Hoti -2,552,220
Skrapar Teki Lalo 677,705
Skrapar Muharrem Hysenllari
Skrapar Maliq Musabelliu 695,952
Devoll Lida Tiko 176,551
Lezhë Hasan Lahi
Gjirokastër Thodhori Labi
Kolonjë Nevrus Këndezi
Kolonjë Nuri Banushi 304,128
Korçë 700,000
Korçë
Korçë Niko Zguri
Korçë
Korçë Ramadan Cane 450,000
Korçë Vangjush Cavali
Korçë Lida Hançe 379,405
Korçë 1,356,300
Korçë Sali Shushka -13,200,840
Korçë -84,320,000
Korçë Ylber Merdani
Korçë Marika Cici 742,719
Mallakastër Halil Pashaj 555,349
Klos MOLL KROSI 970,766
Mat ABDULLA OSMAN
Mat GJERGJ BRUKA 1,702,265
Mat HASAN HYSA 561,928
Mat PRENG SHYT BROZI 2,276,915
Mat FEMI DEDJA 407,457
Mat ALLAMAN KADIU 1,347,664
Shkodër Trashegimtaret Jubani 2,482,092
Vau i Dejës Luce Marzogu 733,423
Shkodër Ndue Nike Nicaj 743,292
Vau i Dejës Hajrulla Facia 1,305,130
Shkodër Zef Kol Dema 2,505,408
Shkodër Pjeter Gjon Gruda 1,901,466
Vorë MERSIN,SHABAN ROMEKJA 590,813
Kavajë ANA PROFNASTA 548,482
Kavajë BEQIR VRAPI 457,408
Rrogozhinë ESAT PAZARI
Tiranë XHAJA 397,406
Tiranë QAZIM VLADI 501,172
Kavajë Rukije Shala 594,585
Mat Kol Dod Rica 199,950
Klos Shpresa Pisli 2,354,196
Mat Hike Çupi 284,840
Klos Liman Muriqi 1,544,680
Mat Luftim Lleshi 885,268
Elbasan MEHMET STRINGA 4,264,943
Fier 3,314,889
Fier Sabri Kanani 9,806,990
Fier Llazi Bani 2,860,167
Roskovec Sefret Ceka 3,631,572
Fier Thoma Sauli
Fier Gori Ristani 8,043,568
Fier Sadik Balla 5,965,170
Bulqizë RIZA SHAHIN GJOKA 2,563,615
Vau i Dejës Zef Ndue Bisha
Tiranë ADRIATIK CANI 4,614,400
Fier Mustafa Kanda 621,146
Roskovec Jashar Sehitaj 1,951,126
Gramsh KAME DERMYSHI 2,702,747
Gramsh NEFAIL DERMYSHI 4,214,464
Gramsh SHEME ZADIA 300,341
Gramsh ZARIF TOCILA 822,493
Kuçovë Engjell Qafa 2,798,475
Kuçovë Fejzi Kafexhiu 589,153
Delvinë Ilia Baci
Krujë Xhemal Lila 1,835,337
Konispol Zija Robi
Krujë 49,396
Krujë Bedrie Koçi 378,751
Krujë 1,223,907
Krujë 2,406,449
Kuçovë Sadik Cekli
Skrapar 877,391
Skrapar Mehmet Mekollari 7,002,224
Skrapar Mehmet Mekollari 645,895
Skrapar Petref Luadhi 741,572
Skrapar Bajame Gjineci, Sabri Gjineci 1,533,464
Memaliaj Safete Hoxha 162,983
Kolonjë Guri Dedo 726,632
Kolonjë Vangjeli Cini, Violeta Cini 0
Kolonjë Hasan Laushka 2,133,037
Pogradec Nazmi Karafili 499,502
Pogradec Kadri Hysenbegasi 104,581
Pogradec Namik Zenel Hysenbegasi 1,039,468
Pogradec Ilo Bice 131,148
Pogradec Margarita Pojanaku 0
Pogradec Lefteri Geri 374,257
Pogradec Ismail Hoxhallari 331,919
Pogradec Sheqere Olldashi 183,377
Pogradec Ida Kodra 2,538,200
Pogradec Spiro Mile
Kurbin Tahir Vokrri
Tiranë Qazim Sula
Vlorë Azbi Kuçi 2,973,772
Vlorë Maria Vruho 1,944,324
Vlorë Merdali Merçani 108,202
Selenicë Evgjeni Çapo 3,043,311
Himarë Shefit Gace 460,800
Vlorë Nuri Muço 440,054
Durrës Bedrije Dedej 7,087,608
Pogradec Kristavgji Kokoneshi 1,678,560
Durrës Besnik Duro -4,866,280
Vlorë Llazar Bitri 1,707,758
Vlorë Vangjel Karbunara 101,049
Durrës Vlash Grami 672,484
Berat Murat Toska 1,674,354
Berat Refat Mehmet Peshtani 5,515,411
Berat Muço Sadik Toska 187,476
Ura Vajgurore Staver Mita 4,150,166
Kuçovë Fetah Muharrem Jaho 4,490,645
Berat Hajdar Rasim Luari 480,497
Berat 1,635,528
Ura Vajgurore Olimbi Janaqi ( Nini ) 142,522
Sarandë Haxheko Proi 4,310,800
Rrogozhinë TRASHEGIMTARET E SADIK DEMIRI TRASHEGIMTARET E SADIK DEMIRI 2,150,678

CILAT VITAMINA DHE SHTESA NË USHQIM DUHET T'I PËRDORNI?

SUMMER pages
SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE
E martë 24 Korrik 2018



VELINA E 'XING'

## Kejvina Kthella ul reçipetat në ballkon



## Trejsi Sejdini ekspozon të pasmet në diell

BULEVARDI POLITIK



- Kuvendi në foto: Majko i nervozuar, Gjiknuri diçka po i sqaron Ahmetajt
- Zëvendësministrja e Ramës rrezikon jetën, ja çmenduria e saj
- Vajza e Ismail Kadaresë, ambasadore në Nju Jork, takon Xherdan Shaqirin e japin mesazhin
- Me bostan dhe pilaf, brenda Akademisë së FRESSH në Jalë, Balla i kujdesshëm për të rinjtë socialistë



Rrëfehet aktori: Ja cila është e fshehta e personazhit "Jam nana"

# DRILON HOXHA, mes 'krimit' dhe pasionit

"Familja është çelësi kryesor i suksesit tim"

## Rrëfehet aktori: Ja cila është e fshehta e personazhit "Jam nana"

# Drilon Hoxha, mes 'krimit' dhe pasionit

## "Familja është çelësi kryesor i suksesit tim"

Egla Xhemali

Ai është një nga aktorët më të dashur për publikun. Eksperiencat e para në media i ka pasur në talent-show, ku është spikatur jo vetëm për talentin, por dhe për këmbënguljen që kishte për të realizuar ëndrrat. Është fjala për Drilon Hoxhën. Padyshim shumica nga ju e kujtojnë si aktorin që imitonte Sali Berishën, rol i cili bëri që t'u rrëmbente zemrën mjaft teleshikuesve. Drilon Hoxha këtë herë vjen në rrëfim krejt ndryshe për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare". Ai ka zgjedhur të na tregojë për aktrimin, projektet më të fundit, familjen dhe verën. Për një periudhë të gjatë kohe u bë virale në rrjetet sociale shprehja "Jam nana". Artisti na sqaron të gjitha të fshehtat e këtij personazhi, që bëri bujë dhe u diskutua gjatë. Aktrimi për të është pasion i fortë, që ka lindur që në fëmijëri, kur ka filluar edhe imitimet e para. Driloni është bërë tanimë pjesë e mjaft projekteve të suksesshme. Ai na pohon se aktualisht është në xhirimet e filmit "Dashuria s'mjafton", që do të jetë aksion, pa humbur dramën dhe notat e dashurisë. Hoxha tregohet tejet entuziast për këtë angazhim të ri dhe ka besim të plotë se do pëlqehet nga publiku. Për të, mbështetja më e madhe është familja. Përpos impenjimeve, Driloni thotë se ka zgjedhur jugun për të kaluar ditët e nxehta të kësaj vere.





**Si ka lindur pasioni për aktrimin?**

Pasionin për aktrimin e kam pasur që i vogël, por duke u rritur, ky pasion sa vinte dhe e zhvillohej më tepër. Gjeja veten time aty ku doja, duke kuptuar dhe që pika ime e fortë ishin imitimet.

**Jeni ndër personazhet që keni marrë pjesë në talent- show. Si ka qenë ajo eksperiencë për ju?**

Ka qenë një eksperiencë mjaft e bukur. Aty nisi rrugëtimi im në botën e televizionit dhe artit.

**Nga të gjitha rolet që keni luajtur, cilin do të veçonit?**

Personazhi që do të veçoja deri tani është Çimi. E veçoj për arsye se është një personazh mjaft karizmatik, i cili të ngel në mendje. Ndërthurja e karakterit të tij mes gangsterit dhe "budallait" të tërheq shumë nga vetja.

**Shprehja "Jam nana" u bë shumë virale në rrjetet sociale dhe pati goxha sukses. Ju pohuat që do të jetë pjesë e një filmi. Kush e pati idenë e krijimit të këtij personazhi?**

"Jam nana" u bë vetë një personazh viral, ku njerëzit filluan ta donin vërtet shumë, gjë që unë e kisha zbuluar më parë si personazh. Kjo karakteristikë e tij më tërhoqi shumë dhe pse jo të mos e fusnim në film?! Mua më pëlqen shumë që të fus në film edhe karaktere nga jeta e përditshme, pasi e bëjnë atë akoma më interesant.

**Me çfarë projektesh është i angazhuar Driloni? Cilat do të jenë surprizat tuaja për publikun?**

Driloni për momentin po merret me projektin e radhës që ka. Filmi quhet "Dashuria s'mjafton". Është një film aksion, dramë ku as notat e dashurisë nuk do të mungojnë. Jam i sigurt që do të vijë një punë mjaft e mirë për publikun shqiptar.

**Në qoftë se nuk do ishit aktor, çfarë profesioni tjetër do kishit zgjedhur?**

Të zgjedhësh një profesion nuk është e lehtë. Unë e dua artin, çdo lloj të tijin. Jam i sigurt që do bëja diçka tjetër që të kishte të bënte me të.

**Deri më tani keni pasur mjaft sukses. Cilat janë objektivat tuaja për të ardhmen?**

Objektivi im është që suksesi mos të ndalojë kurrë. Të kem diçka të bukur për të prodhuar gjithmonë.

**Çfarë vlerësimi keni për artin në Shqipëri?**

Arti është më tepër dhunti sesa leksion i shtytur me forcë. Shqipëria ka vërtet shumë artistë të mirë dhe mendoj se po bëjnë një punë shumë të shkëlqyer.

**Si po shkon kjo verë për ju? Ku keni zgjedhur të pushoni?**

Për momentin po merrem me projektin e radhës. Kemi shumë punë përpara për të arritur standardin dhe objektivat që duhet të ketë kjo punë madhështore. Mundohem nga pak, kur gjej kohën e lirë, të pushoj në bregdetin e jugut.

**Si është marrëdhënia juaj me familjen? Sa ju mbështetësin në hapat që ndërmerrni?**

Familja është çelësi kryesor i suksesit tim. Mbështetja më e madhe dhe kritika ime më e mirë. Janë të gatshëm gjithmonë të jenë pranë meje në çdo hap të ri që hedh.





# Xhensila Pere ndez sërish rrjetin

Pasi ndezi keq rrjetet sociale ditët e kaluara Xhensila Pere provokon sërish. Pas postimit të saj me bikini tejet të vogla, që i nxirrte në pah pjesët intime, Xhensila ka provokuar sërish duke u munduar të thumbojë median. Por këtë herë ajo nuk është mjaftuar me bikinin e saj, por ka nxjerrë në shesh dhe të pasmet e mikes së saj ngjitur. Mesa duket këto ditë të relaksit për bukuroshen do jenë të mbushura me postime provokuese dhe që lënë pa fjalë ndjekësit.






# Kejvina Kthella ul reçipetat në ballkon

Velina e 'Xing' me Ermal Mamaqin është më aktive se kurrë në rrjetet sociale. Kejvina Kthella shpesh ndan foto me bikini nga plazhi, por këtë herë ka guxuar edhe më tepër. Ajo shfaqet në ballkon, teksa ka tentuar të ul reçipetat ngjyrë të zeza. Ajo që bie në sy është trupi super në formë i bukuroshes. Kaq ka mjaftuar për të përvëluar fansat e saj, të cilët kanë shpërthyer në komentet e tyre.





# Françeska Jaçe nuk ndalet, ja çfarë bën modelja

Duket se vera është një nga stinët që ish- banorja e 'Big Brother' e shijon në maksimum. Ndërkohë që Françeska Jaçe është duke marrë rreze dielli kujdeset që fansat të mbeten të informuar për zhvillimet e ditës së saj. Jaçe shpesh ndan video përvëluese me bikini ku fokusi është në format bombastike të saj. Mjafton t'u hedhësh një sy fotove të bukuroshes për të kuptuar se sa 'vuajnë' ndjekësit e modeles në rrjetet sociale. Edhe këtë herë ajo ka bërë po të njëjtën gjë. Postimi i fundit në "Instagram" i ka çmendur të gjithë.




# Trejsi Sejdini ekspozon të pasmet në diell



Miss Shqipëria 2018, Trejsi Sejdini, është një ndër femrat më të komentuara të showbizit shqiptar, e cila ka tërhequr vëmendjen e ndjekësve në rrjetin social "Instagram" jo vetëm me bukurinë, por edhe me pozat super seksi. Së fundmi, Trejsi ka publikuar në "Instastory" një foto që me siguri i ka bërë të gjithë meshkujt të flasin me veten. Missi ka ekspozuar të pasmet bombastike duke marrë rreze dielli, e veshur me bikini me print leopardi, teksa ka filmuar veten nga lart.



Suplementet nuk reagojnë njësoj në njerëz dhe nuk janë të nevojshme për të gjithë në masë të njëjtë. Në mesin e nutricionistëve shpesh zhvillohet debati lidhur me atë që a i plotëson mjaftueshëm pjata jonë të gjitha nevojat e organizmit, posaçërisht kur është fjala për dietat e ndryshme?






# Cilat vitamina dhe shtesa në ushqim duhet t'i përdorni?



Ndonëse ekzistojnë minerale dhe vitamina, të cilat u janë të nevojshme të gjithëve, dietologët botërorë tregojnë cilat janë ato shtesa më të rëndësishme në ushqim dhe kujt posaçërisht i rekomandohen.

*VITAMINA D*

Është ndër vitaminat më të popullarizuara. Kjo vitaminë merret nëpërmjet rrugëve natyrale, nga drita e diellit dhe është e vështirë të absorbohet nëpërmjet ushqimit.

Marrja e vitaminave u rekomandohet të gjithë njerëzve të rritur, duke i përfshirë edhe shtatzënat dhe femrat, të cilat ushqejnë foshnjat me qumësht gjiri, si edhe fëmijëve që i kanë mbushur një vit. Fjala është për dozën ditore prej 10 miligramëve, posaçërisht gjatë vjeshtës dhe dimrit, për shkak të zvogëlimit të vitaminës D.

*HEKURI*

Marrja e tij është shumë me rëndësi për femrat e reja gjatë ciklit të menstruacioneve, si edhe për veganët dhe vegjetarianët thekson nutricionistja, duke plotësuar këtë konstatim me faktin që 27 për qind e femrave kanë mungesë hekuri. Hekuri më së shumti është i theksuar te vajzat midis moshës 11 dhe 18 vjeç (54 për qind të tyre vuan nga kjo mungesë).

Mungesa e hekurit mund të shkaktojë aneminë, lodhjen kronike, probleme me frymëmarrjen (frymëmarrje e shkurtër), lëkurë të zbehtë.

*VITAMINA B12*

Kjo vitaminë është shtesë kryesore për veganët, pasi që kryesisht gjendet në produktet shtazore dhe në mishin e kuq.

Kjo vitaminë është e rëndësishme për sistemin e shëndetshëm nervor dhe për imunitetin dhe është e nevojshme për krijimin e rruazave të kuqe të gjakut.

*KALCIUMI*

Kalciumi është i pasur me burime natyrore siç janë produktet e qumështit dhe perimet. Konsumimi i tabletave shtesë mund t'u rekomandohet atyre, të cilët kanë probleme me dendësinë e eshtrave, pasi që kalciumi është kyç për mirëmbajtjen e shëndetit të eshtrave.

Niveli i ulët i kalciumit në gjak, është i njohur si hipokalcemi, mund të manifestohet në simptoma, siç janë spazma e muskujve, ngërçet dhe, në raste të rënda, epilepsia.

*THARTIRA FOLIKE*

Është posaçërisht e rëndësishme për shtatzënat. Të gjitha femrat, të cilat planifikojnë të lindin fëmijë duhet të marrin shtesë të thartirës folike.

Kjo ka të bëjë edhe me të gjitha shtatzënat deri në javën e 12-të të shtatzënisë, për shkak që thartira folike mund të ndihmojë në preventivën e defekteve të gypave neuronikë, siç është spina bifida. Atëherë palca kurrizore e fëmijës nuk zhvillohet në tërësi në mitër, gjë që çon deri te zbrazëtia në kurrizin e bebes.

*VITAMINA A DHE VITAMINA C*

Rekomandohet marrja e tyre nëpërmjet ushqimit të llojllojshëm, siç janë karotat, kivi, specat... Fëmijëve, të cilët sapo fillojnë me ushqimin e llojllojshëm, u rekomandohen pika me këto vitamina, të cilat merren një herë në ditë.

Pikat veprojnë në mënyrë preventive në humbjen e këtyre vitaminave në organizëm të fëmijës dhe i mundësojnë zhvillimin e drejtë të tyre.

## Kuvendi në foto: Majko i nervozuar, Gjiknuri diçka po i sqaron Ahmetajt

Një sallë më shumë se gjysma bosh ajo e seancës së Kuvendit para ditën e djeshme, e cila ishte edhe seanca e fundit plenare për këtë sesion. Ndërkohë që ishin planifikuar 14 pika në rendin e ditës shumica e karrigeve ishin bosh. PD kishte njoftuar se do të ishte vetëm pak minuta në seancë për të bërë një deklaratë, ndërsa deputetët e LSI-së u larguan pas një ore.



Agjencia e fotografisë, LSA ka fokusuar disa momente nga ajo çfarë po ndodh brenda. Dihet që fotoja kap detajet dhe ato që të bien në sy është fytyra e vrenjtur e ministrit të Diasporës Pandeli Majko. Apo dhe mimikat me duar të ministrit Damian Gjiknuri që duket se po i shpjegon diçka kolegëve ministra. Nga gjestet me duar duket që tema e diskutimit është tepër serioze dhe ka marrë të gjithë vëmendjen e ministres së Arsimit Lindita Nikolla dhe ministrit të Financave Arben Ahmetaj. Nga ana tjetër, ministrja e Shëndetësisë Ogerta Manastirliu duket indiferente.

## Zëvendësministrja e Ramës rrezikon jetën, ja çmenduria e saj

Një nga emrat e rinj që u bënë pjesë e kabinetit qeveritar "Rama 2" një vit më parë në nivel zëvendësministri ishte edhe Ornela Çuçi. Ajo vjen nga fusha e mësimdhënies dhe u bë e njohur për opinionin publik si një nga të paktët njerëz që patën guximin të mbronin ligjin që mundësonte importin e mbetjeve në vendin tonë. Dhe për këtë guxim, kreu i qeverisë e shpërbleu atë me një post zëvendësministri në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit. Në fakt Çuçi duket se e ka justifikuar këtë besim të Ramës, pasi ajo është parë shumë aktive në çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe sidomos në nismën për ndalimin e qeseve plastike dhe përdorimin e materialeve të riciklueshme. Kohët e fundit ajo është angazhuar në promovimin e nismës "Smile Albania" që do të shoqërojë të gjithë sezonin turistik dhe nëpërmjet të cilit Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit kërkon të paraqesë bukuritë e natyrës shqiptare por edhe në mikpritjen e turistëve që vijnë në vendin tone. Për të tërhequr vëmendje për këtë nismë ajo ka guxuar që të hidhet edhe me parashutë nga Llogoraja, ndërsa adrenalinën që të ofron një fluturim i tillë e ka fiksuar edhe nëpërmjet një video të cilën e ka postuar në faqen e saj në 'Facebook'.



# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

## Vajza e Ismail Kadaresë, ambasadore në Nju Jork, takon Xherdan Shaqirin e japin mesazhin

Ambasadorja e Shqipërisë në OKB Besiana Kadare ka takuar në Nju Jork, futbollistin shqiptar Xherdan Shaqiri, i cili në ndeshjen e Zvicrës kundër Serbisë për Kupën e Botës, festoi golin me simbolin e shqiponjës. "E kënaqur që takova në NY Xherdan Shaqirin, futbollistin e mirënjohur të Zvicrës, që shënoi gjatë Kupës së Botës kundër Serbisë. Ai është krenar për të qenit shqiptar dhe ne e festuam duke e bërë së bashku këtë gjest tashmë të famshëm, që pasqyron flamurin e shqiponjës dykrenare. Shumë falënderime për Fadil Berishën për pritjen!",-shkruan Besiana Kadare.



## Me bostan dhe pilaf, brenda Akademisë së FRESSH në Jalë, Balla i kujdesshëm për të rinjtë socialistë

Të rinjtë e FRESSH, ashtu siç dhe një vit më parë, kanë zgjedhur bregdetin e Jalës, për atë që Balla e quan Akademinë Verore 2018. Por të gjithë jemi kuriozë të dimë se si po kalojnë kohën të rinjtë e Partisë Socialiste në kampin e organizuar Jalë. Me anë të postimeve në rrjetet sociale anëtarë të ndryshëm të FRESSH kanë zbuluar aktivitetin e tyre ditor. Siç duket dhe nga këto foto të postuar nga aktivistët, të rinjtë kanë një frymë grupi midis tyre, teksa shihen se po ndihmojnë njëri-tjetrin për të shërbyer darkën. I pranishëm në ndarjen e racioneve të darkës është dhe kreu i grupit Parlamentar në Partinë Socialiste Taulant Balla, i cili po ndihmon për t'u shërbyer të rinjve. Ndërkohë që disa ditë më parë me anë të një postimi në rrjetet sociale kreu i grupit parlamentar në PS, Taulant Balla shkruante se në raundin e parë të rinjtë e qarqeve të Vlorës, Beratit, Shkodrës, Lezhës dhe Elbasanit do të trajnohen mbi hartimin e politikave lokale, ngritjen dhe lobimin për problematikat komunitare dhe mjedisore.



LETRA

# Artistët, letër Metës: Mos dekreto ligjin për teatrin

**Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar përmes një letre, i ka kërkuar Presidentit të Republikës, Ilir Meta, të mos dekretojë ligjin që u miratua në Kuvend me 5 korrik. Duke kërkouar takim me të që të sqarojnë qëndrimin e tyre, artistët dhe shoqëria civile shprehen se vendi ndodhet pa Gjykata Kushtetuese dhe në këtë mënyrë Presidenti nga filtri i parafundit është i fundit për ligjet. Më poshtë letra e plotë.**



**ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT**

**Tiranë, më 23.07.2018**
**Drejtuar: SH.T.Z. Ilir META**
**President i Republikës së Shqipërisë**

Objekti: Kërkesë për kthimin për rishqyrtim dhe korrigjim në parlament të ligjit “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet juridike dhe themelet morale të ndërtimit të shtetit demokratik.

Kërkesë për takim zyrtar të një përfaqësie të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit në Institucionin e Presidencës me Presidentin e Republikës.

I nderuar Zoti President,

Në emër të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, një grupim që bashkon disa organizata jofitimprurëse jopartiake dhe lëvizje qytetare, si edhe shumë aktivistë civilë, po ju ridrejtohemi me një letër të dytë brenda pak ditësh duke ju paraqitur argumente shtesë dhe shqetësimin qytetar, në lidhje me nevojën për kthimin për rishqyrtim të ligjit të miratuar nga Kuvendi “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Në vitin 2000, Ju me përgjegjësi të lartë qytetare, keni miratuar VKM nr. 180, datë 13.04.2000 “Për shpalljen ansambël monumentkulture të aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës”. Në vitin 2017, pa asnjë arsye objektive, pa konsultim publik me ekspertë apo qytetarë, Këshilli i Ministrave përmes VKM nr. 325 datë 12.04.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth” ka vendosur zvogëlimin e zonës së mbrojtur në mënyrë dramatike, duke lënë jashtë edhe territorin dhe ndërtesat e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar Eksperimental.

Arsyet e përgjysmimit të zonës së mbrojtur në qendrën historike të qytetit të Tiranës kuptohen qartë tashmë, kuptohet edhe heshtja me të cilën është kaluar ky vendim. Kuptohet qartë se ky është një plan i paramenduar, të paktën që prej datës 12.04.2017, shumë kohë përpara se Bashkisë Tiranë t’i vinte nga Fusha shpk një “ofertë e pakërkuar”. Pra u nxor zona nga zonë e mbrojtur dhe pastaj kompania private bëri ofertën e pakërkuar, edhe pse nuk është kufitar me truallin e Teatrit Kombëtar, edhe pse ka në pronësi vetëm 3% të territorit, që kërkohet të zhvillohet.

Zoti President,

si asnjë vend demokratik në botë, Shqipëria gjendet pa Gjykatë Kushtetuese, ku mungon kuorumi, jo thjesht për të shqyrtuar ligjet, por edhe për t’i regjistruar si ankimime, pasi në këtë moment Gjykata, është jo vetëm jashtë funksioneve juridike, por edhe atyre më minimale administrative. Sikur ky të jetë ligji më i mirë në botë, juridiksioni dhe fryma e Kushtetutës sonë, e kërkon që çdo ligj mund dhe duhet të jetë i ankimueshëm për parim. Ju si President jeni garanti i Kushtetutës, garanti i të drejtave tona qytetare dhe ligjore, por në çdo rast Kushtetuta jonë ia ka lënë gjykimin mbi kushtetutshmërinë e ligjit Gjykatës Kushtetuese. Pra, në kushte normale, ju do të ishit filtri i parafundit në proces, por në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk është një opsion real, ku ne si qytetarë të mund të kërkojmë të gjykohet çështja, atëherë përgjegjësia mbi Ju është vendimtare. Ju tashmë jeni filtri i fundit dhe final në mungesë të Gjykatës Kushtetuese. Ndaj ne si qytetarë kërkojmë nga ju që ta ktheni atë për rishqyrtim.

*“Ja shkeljet ligjore në një vend pa Gjykatë Kushtetuese”*

Ligji për shembjen e Teatrit, është një propozuar si një ligj i posaçëm, pa asnjë justifikim, duke injoruar tërësisht kornizën ekzistuese të legjislacionit në Shqipëri. Për pasojë, ky ligj meriton më shumë se çdo ligj tjetër që të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, për të provuar kushtetutshmërinë e tij. Në këto kushte, ne si qytetarë kërkojmë, në mënyrë të vendosur që, në zbatim të nenit 85 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ktheni për rishqyrtim dhe korrigjim në Kuvend ligjin “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet juridike dhe themelet morale të ndërtimit të shtetit demokratik, duke i dhënë kohë sistemit të drejtësisë të plotësohet, e nëse ky ligj rimiratohet, me kokëfortësi prej mazhorancës, atëherë ne të kemi mundësinë e vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese.

Zoti President,

ligji që ju keni në tryezë, është i shtrembëruar në frymë, pasi në vend që të jetë një mekanizëm juridik që të rregullojë marrëdhënie shoqërore në tërësi, ky ligj është i ndërtuar në formën e një kontrate komerciale, me fitues të përcaktuar dhe me vlefshmëri për disa mijëra metra katrorë. Me këtë ligj shkelet balanca mes pushteteve,

# Elma Doresi: Miu që nuk e pashë kurrë

*Teksa debati për teatrin ka prekur javën kritike, regjisorja Elma Doresi ka dhënë një mesazh që duket se i çon ujë mbrojtjes së tij.*

Unë minjtë i kam frikë, ose më saktë kur i shoh (nëpër kazanë plehrash në përgjithësi) më krijojnë një pështirje, një dridhje trupi, më përzihet në të njëjtën kohë, mund të them pa frikë se pasi unë mund të jem “takuar” me miun nuk e marr veten për disa orë. Merre me mend pastaj nëse do të ndeshesha me të e më pas të më duhej të krijoja.

Po krimbin? Apapapapapapa. Njëherë në një hotel të një qyteti në Shqipëri, ishim për festival teatri. Një natë fjeta e të nesërmen ndërrova hotel. Nuk kishim lek, as pordhë e thënë popullorçe, ishim studentë mbi të gjitha. Dhe lekët që kisha marrë me vete më shërbyen për ilaçet dhe qetësuesit që m’u deshën në spital të këtij qytetit për atë çfarë shkaktoj ky krimb tek unë. Merreni më mend përsëri nëse do isha në proces krijimi e të dija apo të ndjeja prezencën e këtij krimbit pranë.

Do thoni ju po ç ‘t’u tek dhe ty o Elma të na flasësh për minj e krimba sot që mund të flasësh për temën e pushimeve?!

Sepse nuk mund ta kapërdij dot shpifjen!

Lidhur me temën më të përfolur, me temën që ju ka tërhequr ose ju ka mërzitur tërë këto muaj: Teatri Kombëtar dhe fati i tij!

Të flasësh për godinën e tij dhe për kushtet që ai ofron natyrisht janë specialistët e këtij fushe, ndërsa ne dimë të themi vetëm: është ftohtë, është vapë, ka lagështirë. Kaq! Ah di dhe që pasi je shkatërruar disa net deri në të gdhirë për të realizuar atë ndriçim, ditën e tretë ose javën e dytë të shfaqjes shikon se si fillon “disko” live dhe dëgjon shprehjen: “Ra ura”! Por kjo nuk ka lidhje me godinën, por mesa di unë të mikseri a ku ta di unë fiks që është porositur dhe dikur do të vijë.



Gjithsesi kaq di unë. Por netëve në Teatër dhe ditëve aty, për 3 vite, nuk u takova kurrë me këtë Miun apo Krimbin. Nëse unë do ta dija që aty ka minj apo krimba, vëmendja ime do ishte: Ku është? Mos po vjen? Syri im do kontrollonte për ta e jo në skenë, vëmendja ime nuk do ishte tek aktorët, por tek krimbat e minjtë. Kam guxim në vepra dhe në përzgjedhje aktorësh, aty jam super guximtare, kam besim tek “Elma” por nëse vjen puna tek minjtë e krimbat jam një fëmijë 5 vjeç, jua siguroj!

U zgjata disi për “Plakun tim të bukur Teatër”, sepse nuk munda dot t’i kapërdija këto gjëra apo tema bisedash, të cilat mundohen ta baltosin emrin e Teatrit.

Ah, nëse minjtë apo krimbat janë në simbol, është tjetër gjë.

PS: Unë nuk jam as Teatri, as Koloseu që krijoj artin, as artiste, as talenti. Jam thjesht Elma që për aq kohë sa punova në Teatër, takova lagështirën, të ftohtin, por dhe magjinë e tij që mbas 1 jave më bënte t’i harroja të gjitha e të thosha: Atëherë kur është shfaqja e radhës?!

pasi Kuvendi kthehet në një zyrë që miraton me vulë leje ndërtimi, që vijnë me porosi nga qeveria, duke shkelur edhe ligjet që ka miratuar vetë, për koncesionet dhe për partneritetin publik-privat, ligjin e prokurimeve e shumë ligje tjera.

Konkretisht, ky ligj anashkalon dhe vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Çdo kontratë publike duhet t'i nënshtrohet procedurave dhe kritereve të ligjit për prokurimin publik.

Kjo formë veprimtarie ekonomike e parashikuar në këtë ligj, vjen në kundërshtim me standardet e Bashkimit Europian, ku ne aspirojmë të integrohemi dhe konkretisht me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), të nënshkruar dhe ratifikuar nga Shqipëria, ku sanksionohet detyrimi i shtetit shqiptar, që kontratat publike t'i nënshtrohen konkurrencës së lirë dhe transparencës (nenet 70 – 77). Me këtë ligj, ky standard europian i detyrueshëm për ne, është shkelur. Për ta konkretizuar, po sjellim si shembull ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Në nenin 4 të ligjit "Për prokurimin publik" parashikohen përjashtimet nga procedurat e këtij ligji, pra rastet në të cilat kontratat publike nuk i nënshtrohen konkurrencës. Deri në vitin 2012, në këtë nen, si përjashtim, ka ekzistuar dhe një fjali: "dhe ato që rregullohen me ligj tjetër". Pra, deri më 2012, lejohej që, me ligje të tjera të parashikoheshin kontrata publike, të cilat si përjashtim nga ligji i prokurimeve mund të mos i nënshtroheshin konkurrencës.

Por me ndryshimin e vitit 2012 që iu bë ligjit në fjalë, kjo fjali u shfuqizua. Dhe konkretisht, me ligjin nr.131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, hiqen fjalët "dhe ato që rregullohen me ligj tjetër", ndryshim që sigurisht diktohej nga nenet 70-77 të MSA-së së nënshkruar nga shteti shqiptar.

Nëse ky ligj, lejohet të hyjë në fuqi nga Ju, zoti President, shkelet fryma e decentralizimit të pushteteve, e sanksionuar në Kushtetutë, duke injoruar rolin e pushtetit vendor, i cili shpreh vullnetin e qytetarëve të Tiranës, nëpërmjet votës në Këshillin Bashkiak, si i vetmi institucion i legjitimuar me votë të cilësuar, për të tjetërsuar pronën publike.

Me vendimin nr. 3, datë 2.02.2009, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë përcakton qartësisht si më poshtë:

"Gjykata, në jurisprudencën e saj kushtetuese, i ka analizuar parimet bazë mbi të cilat e ushtrojnë pushtetin organet e pushtetit qendror dhe të qeverisjes vendore. Qeverisja vendore ngrihet dhe funksionon mbi bazën e parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet nëpërmjet parimit të autonomisë, i cili kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror, në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të tij qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit "ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve". Gjykata vlerëson se në një sistem që bazohet mbi vetëqeverisjen, parimi i subsidiaritetit kërkon që problemet të vështrohen si çështje vendore, që kanë ndikim në interesin e përgjithshëm. Njësitë vendore vetëqeverisëse nuk mund të pengohen në hapësirën juridiksionale të tyre, nga organet e pushtetit qendror, pasi ato kanë fushën e tyre të veprimtarisë të parashikuar nga Kushtetuta. Vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues, që konsiston në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të punëve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113), në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113, shkronja "b", "c", "ç") (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006).

Kushtetuta në nenin 13 sanksionon qartë se: "Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore."

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me mënyrën e menaxhimit, kalimit të pronësisë, apo dhënies në përdorim të pronës shtetërore, që është në pronësi të pushtetit vendor, ka përcaktuar një bazë të qartë kushtetuese dhe ligjore. Konkretisht, Kushtetuta në nenin 113 ka përcaktuar se:

"1. Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut:

a) rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;

b) ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;"

Sipas nenit 81 pika 2 germa (a) të Kushtetutës:

"2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;"

Në zbatim të këtij neni, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si ligj organik për këtë fushë të veprimtarisë shtetërore. Ky ligj në nenin 54 germa (e) përcakton:

"Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;"

Ndërsa në nenin 55 pika 4 sanksionon:

"4. Vendimet merren me jo më pak se tri të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar ne˜ shkronjën "e", te˜ nenit 54, te˜ këtij ligji."

Sa sipër, rezulton qartësisht, se në Republikën tonë, ndër vite, legjislatori ka mirëpërcaktuar një bazë ligjore të qartë, deri në nivel ligjesh organike, pra ligje që miratohen me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Ndërkohë, Kuvendi me një ligj të posaçëm, që kërkon një shumicë të thjeshtë, mbivendos bazën ligjore duke anashkaluar ligjin organik dhe duke zhbërë kështu parimin kushtetues të decentralizimit, që parashikohet qartësisht nga neni 13 i Kushtetutës.

Vetiu qytetarëve u lindin pyetjet:

1. Përse duhej që Kuvendi të miratonte një ligj të posaçëm, kur ligji organik i ka dhënë kompetencë Këshillit Bashkiak për këtë vendimmarrje?

2. A mundet që një ligj, i cili miratohet me shumicë të thjeshtë, të anashkalojë dhe t'i mbivendoset një ligji, për miratimin e të cilit kërkohen 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, siç është ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"?

Zoti President,

nëpërmjet këtij ligji certifikohet vjedhja, pasi të gjitha faktet thonë, se ato që shkruhen në ligj dhe në relacionin shoqërues janë gënjeshtra. Ky ligj nuk është thjesht i padrejtë, por është edhe i manipuluar në përmbajtje.

Zoti President,

nga Brukseli kanë ardhur dy seri pyetjesh dhe kërkesa për informacion, drejtuar qeverisë, që do të thotë se çështja ka marrë përmasa europiane. Ne mund t'jua konfirmojmë këtë fakt nga takimi që kemi pasur me Zyrën e Delegacionit Europian dhe presim nga institucioni juaj të njëjtin interesim për informacion, në lidhje me këtë çështje kyçe për të ardhmen europiane të Shqipërisë. Duam t'ju kujtojmë se dy organizata, nga më prestigjiozet në Europë, për ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë, "Europa Nostra" dhe "Docomomo", e kanë shpallur Teatrin Kombëtar dhe atë Eksperimental si objekte të trashëgimisë europiane, duke ngritur alarmin tek institucionet ekzekutive për goditje ndaj trashëgimisë.

Në ndërtesat që Ministria e Kulturës i ka shpallur si të pavlera, veç Teatrit Kombëtar, janë themeluar institucionet më elitare të vendit, si Instituti i Shkencave – Sot Akademia e Shkencave, Filarmonia Shqiptare - sot Teatri i Operës dhe Baletit, Estrada e Tiranës - sot Teatri i Metropolit, Cirku i Tiranës - sot Cirku Kombëtar, Instituti i Lartë i Arteve - sot Universiteti i Arteve, Teatri Kombëtar i Komedisë - sot Teatri Kombëtar Eksperimental, por, mbi të gjitha, dhe që ka rëndësi kapitale për kujtesën e kombit tonë, është zhvilluar gjyqi i parë politik i diktaturës komuniste, ku janë dënuar me vdekje 19 të pafajshëm dhe burgosur 40 të tjerë. Zhdukja e kësaj godine, do të ishte një dëshmi më pak për kujtesën kolektive dhe një arsye më pak për t'u distancuar nga një periudhë e errët 45-vjeçare e historisë sonë.

Zoti President,

qëndresa tashmë 6–mujore për Teatrin ka fituar konsensus të gjerë publik, me një peticion drejtuar Ju dhe institucioneve tjera, me më shumë se 5000 firmëtarë, të cilët më 12 korrik, marshuan paqësisht në bulevard, për të shprehur vullnetin e tyre në mbështetje të kësaj kauze. Letra të veçanta ju kanë drejtuar edhe mbi 130 artistë teatri dhe 77 arkitektë dhe urbanistë.

Në kushtet aktuale, dekretimi i këtij ligji, do krijonte jo thjesht padrejtësi, por pështjellim shoqëror, pasi këtu cenohet e drejta, cenohet balanca e pushteteve, cenohet decentralizimi i pushteteve, cenohet trashëgimia dhe kultura e vendit, cenohet integriteti njerëzor dhe moral i artistëve, si një komunitet që sjell dritë në shoqërinë shqiptare, por mbi të gjitha cenohet interesi publik, i cili është edhe motivi kryesor se pse institucioni që ju drejtoni ka atë rëndësi që ka dhe që ne kemi besimin se ju do ta përligjni duke mos e dekretuar këtë ligj.

Përfundimisht, nisur nga arsyet e mësipërme, kërkojmë nga ju që, në zbatim të nenit 85 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ktheni për rishqyrtim dhe korrigjim në Kuvend ligjin "Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet juridike dhe themelet morale të ndërtimit të shtetit demokratik.

Me këtë rast, ju shprehim dhe njëherë gatishmërinë dhe dëshirën, për t'u ulur dhe folur sy më sy, si përfaqësues të Aleancës, me qëllim që të merret vendimi më i mirë nga institucioni që Ju drejtoni.

# ÇABEJ E QËNDRO PËRKTHEHEN NË ITALISHT NGA MINISTRIA E KULTURËS




Ministria e Kulturës ka shpallur dje listën e fituesve të Fondit të Përkthimit nga Gjuha Shqipe në Gjuhë të Huaj për vitin 2018.

Fondi i themeluar në vitin 2015 për ministrinë është një dëshmi në promovimin dhe mbështetjen e përkthimit të letërsisë shqipe në gjuhë të huaj. Gjatë këtyre viteve janë mbështetur 11 përkthime të veprave të autorëve të rëndësishëm të letrave shqipe si: Fatos Kongoli, Luljeta Lleshanaku, Bashkim Shehu, Ridvan Dibra, Stefan Çapaliku, Ardian Vehbiu, Mira Meksi, e të tjerë.

Fondi për Përkthimin nga Gjuha Shqipe në Gjuhë të Huaj shërben, gjithashtu, për mbështetjen e përkthyesve të huaj që përkthejnë nga gjuha shqipe, për nxitjen e interesit të tyre për letërsinë shqipe dhe për lehtësimin e kostove të botimit të shtëpive të huaja botuese. Gjatë këtyre tre viteve janë vënë në dukje dhe vlerësuar për bashkëpunimin përkthyesit e huaj: Esperanza Roces Gonzales, Evelyne Noygues, Caterina Zuccaro, Lucia Paprckova, Anna Couthures, Valentina Notaro, etj. Edhe pse ky fond u krijua për të ndihmuar me përparësi përkthyesit e huaj që përkthejnë nga gjuha shqipe, nuk kanë munguar dhe mbështetjet për përkthyesit shqiptarë që kanë tashmë një njohje dhe një përvojë të gjatë në përkthimet në gjuhë të huaj. Kjo nisur nga nevoja e ngutshme dhe boshllëku që ekziston në formimin e përkthyesve të rinj të interesuar për të përkthyer nga gjuha shqipe.

Përmes këtij Fondi Ministria e Kulturës thotë se kujdeset për të vendosur standardin e respektimit të së drejtës së autorit si një nga kushtet e domosdoshme për t'u përzgjedhur.

Nga 10 aplikime të shtëpive botuese e përkthyesve, u përzgjodhën 6 prej tyre, të cilët kaluan me sukses fazën e seleksionimit dhe vlerësimit nga kolegjiumi i ngritur për shqyrtimin e dosjeve.

Brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së fituesve, do të kontaktohen shtëpitë botuese të përzgjedhura për të caktuar afatin e nënshkrimit të kontratës.

Fituesit janë si më poshtë:

- Shtëpia Botuese: Rubettino Editore
Titulli i librit: "Kinostudioja "Shqipëria e Vjetër" ;
Autori: Gëzim Qëndro
Përkthyesi: Caterina Zuccaro

-Shtëpia Botuese: Besa Editrice
Titulli i librit: "Piramida e shpirtrave"
Autori: Virgjil Muçi
Përkthyesi: Ada Prizreni

-Shtëpia Botuese: Edizioni Controluce
Titulli i librit: "Në botën e arbëreshëve të Italisë"
Autori: Eqrem Çabej
Përkthyesi: Silvia Storti

- Shtëpia Botuese: Rubettino Editore
Titulli i librit: "Loja, shembja e qiellit"
Autori: Bashkim Shehu
Përkthyesi: Paolo Rago

- Shtëpia Botuese: Plethora Editions
Titulli i librit: "Fluturimi mbi teatrin e Kosovës"
Autori: Jeton Neziraj
Përkthyesi: Eleana Zhako

- Shtëpia Botuese: Salento Books
Titulli i librit: "Qyteti plak"
Autori: Saimir Muzhaka
Përkthyesi: Valentina Notar

Opinioni i Ditës

# SHBA-Rusi, normalizim i marrëdhënieve dhe i dialogut

Nga Vasil Kureta

*(vijon nga faqja 1)*



... përmbajtja e këtij takimi, apo se është përcjellë pak informacion për tematikën e përmbajtjen e diskutimeve, për dakordësimet e ndarjet konkrete, vjen edhe një njoftim se presidenti Trump e ka ftuar Putin për një vizitë në SHBA. Ky është një zhvillim që mundëson shumë pyetje të rëndësishme. Është e vërtetë që të dy presidentët e vlerësuan pozitivisht takimin mes tyre, ku pohuan se kishin folur për shumë tema, por pa dhënë hollësi për opinionet, argumentet, dakordësitë apo mosdakortësitë, apo se ku ndahen e ku pajtohen. Në këto kushte konstatohet se ndaj presidentit Trump janë përcjellë një furi kritikash, madje edhe akuza se nuk është përpjekur të mbrojë interesat e SHBA dhe të perëndimit, që nuk u konstatua kjo dukuri ndaj Putinit. Putini edhe pse i rezervuar të tregonte më shumë për takimin apo që të afirmonte një sukses të Rusisë e të tijin personal në politikën e jashtme, gjeti të udhës të tregojë muskujt apo dhëmbët, forcën ushtarake, duke ekspozuar tipe të reja e të sofistikuara armësh, si pjesë e një gare të ethshme armatimi.

Brenda këtij zhvillimi, me rëndësi të veçantë është pyetja nëse ka nisur realisht një proces, që çon drejt një marrëdhënieje të re mes SHBA dhe Rusisë? Jemi përpara vetëm një normalizimi të dialogut, apo edhe të një normalizimi të marrëdhënieve, që do të mbushë këtë proces ndryshimi? A mund të mbyllet ky takim në rastet e takimeve të dështuara? Nëse vërtet po fillon të shtratohet një marrëdhënie e re, atëherë kjo do të jetë vërtet e vështirë. Mes tyre ka shumë gjëra esenciale që ndajnë, siç ka gjera të rëndësishme, që nevojitet të dialogojnë e kontribuojnë në mbrojtje të stabilitetit, paqes e sigurisë, por edhe për interesa ekonomike e tregtare. Vendosja e prioriteteve në këto kushte është përparësi, por edhe dialogu për ushtrimin e përgjegjësive ndaj sigurisë e stabilitetit është domosdoshmëri. Megjithatë, në këtë moment nuk mund të mos tërheqë vëmendjen fakti, që nëse Trump bën lëvizjen e tij duke e ftuar Putinin në Shtëpinë e Bardhë, Putini lëviz të bëjë të fortin, të tregojë forcën ushtarake. Pse i nevojitet Putinit ky komponent i fuqisë, aq më tepër kur ka si "aksesorë" edhe propozimin për referendum në lindjen e Ukrainës, të kontrolluar nga separatistët prorusë, apo thënë më saktë nga Rusia, apo dhe kur kërkon nga NATO të ndërpresë interesimin për Gjeorgjinë dhe Ukrainën. Kjo lëvizje e Putinit nuk mund të besohet se bëhet më shumë për nevoja të brendshme, ku Putini sapo ka filluar një mandat të ri presidenti, që ka edhe përvojën e pasur të drejtimit me dorë të fortë. Nuk mund të mohohet që në këtë demonstrim force, ka një lloj trysnie si ndaj SHBA-ve, por sidomos ndaj NATO-s, nëse mban parasysh disa reagime të NATO-s e masa që ka ndërmarrë në funksion të forcimit të mbrojtjes, sidomos të krahut lindor të aleancës euroatlantike, apo një trysni për anulimin e stërvitjes së programuar me vendet balltike. Me këtë lëvizje, Putini mendon se i ndihmon atij procesi, që beson në shpërbërjen e perëndimit dhe të NATO-s. Mbase ky demonstrim fuqie lidhet edhe me synimin që ka Rusia për të përcaktuar zonat e influencës së saj në Europë, aq më tepër që lëvizjet e NATO-s, për forcimin e krahut lindor të saj, Rusia i ka interpretuar si prirje për të rrethuar Rusinë. Nuk mund të harrohet apo të lihet mënjanë deklarata e Putinit, disa vite më parë, që e ka konsideruar shpërbërjen e BRSS si një katastrofë të madhe gjeopolitike, apo nuk mund të mos konsiderohen reagimet e forta të perëndimit, si në rastin e krizës gjeorgjiane, aneksimin e Krimesë dhe shpërthimin e konfliktit në lindje të Ukrainës, që prodhuan përveç dy marrëveshjeve "Minsk", edhe sanksionet ndaj Rusisë.

Kjo trysni e tanishme force mund të jetë edhe pjesë e strategjisë për të vënë në provë apo për një presion për rishikim të mundshëm të aleancës të nenit 5, që rregullon problemin e mbrojtjes kolektive. A ishte një rastësi e thjeshtë, pyetja e gazetarit për presidentin Trump, në lidhje me aplikimin e mundshëm të këtij neni të mbrojtjes kolektive, duke iu referuar një vendi ballkanik si Mali i Zi, anëtari më i ri i aleancës? Ndoshta kjo trysni ka domethënien se në ndarjen e fuqisë e rolit me SHBA, Rusia kërkon të llogaritet mirë fuqia ushtarake e saj. Ky demonstrim i tanishëm i fuqisë ushtarake është edhe një lloj trysnie ndaj BE. Vërtet Rusia ka interesa të mëdha, sa i përket bashkëpunimit ekonomik e tregtar, por në funksion të interesave të një roli fuqie në hapësirën europiane, e mendon Europën jo si të bashkuar, si BE, por si një Europë ku secili vend mendon për veten e vet. Rusia ka interes jo vetëm që ta shohë Perëndimin të grindur e të përçarë, jo vetëm të shohë thellim të ndarjes SHBA-BE, jo vetëm një BE të ndrydhur në kontradikta të brendshme, por sidomos që projekti europian të dështojë e mos avancojë. Kuptohet që përballë perëndimit, Rusia ndjen edhe epërsinë që ka modeli i zhvillimit, i ngritur mbi sistemin e vlerave, prandaj edhe intereson fragmentizimi i BE-së. Ajo synon e do të synojë të shfrytëzojë interesa konkrete ekonomike e tregtare, siç është edhe ajo për blerjen e gazit, që të forcojë prezencën e saj në BE, por edhe për të ushqyer grindjen brenda perëndimit. Të gjithë këta përbërës nuk mund të mos merren në konsideratë, kur analizon marrëdhënien aktuale mes SHBA dhe Rusisë, por edhe pritshmëritë ndaj ecurisë së saj. Takimi i Helsinkit duket se e ka hapur rrugën e një normalizimi të dialogut mes SHBA dhe Rusisë, që do t'i shërbejë edhe normalizimit të marrëdhënies mes tyre, tashmë në kushte të reja. Ndoshta që në këtë takim Putini mund të ketë trajtuar edhe vizionin e tij për rolin e Rusisë në zhvillimet botërore, përfshi edhe ambiciet më kryesore të saj, që kuptohet, nuk mund t'i realizojë duke anashkaluar pikëpamjen e qëndrimin e SHBA, por edhe të BE. Edhe pse mund të duket e vështirë, por Putinit i intereson që të mos ketë përballë një perëndim të bashkuar, apo një SHBA, lider i padiskutueshëm i perëndimit, por një perëndim të grindur dhe një NATO jashtë funksionimit të saj.

Në këtë drejtim duket që Rusia ka pasur strategji konkrete, por edhe do të synojë të bëjë trysni, të përpiqet të ushqejë ndarjet e përçarjet, duke shfrytëzuar edhe çështjet ekonomike e tregtare, por edhe problematikën politike, sidomos asaj që lidhet me mbrojtjen dhe funksionimin e sistemit të vlerave dhe rritjes së trysnisë nacionaliste, sovraniste, autoritariste, prirjeve kundër funksionimit të demokracisë liberale funksionale, sundimit të ligjit e të shtetit juridik, si dhe të fenomenit "exit". Natyrisht, që në këtë moment Rusia ndjen nevojën e ngutshme të çlirohet sa më parë nga sanksionet ekonomike, që janë vendosur ndaj saj nga perëndimi, për aneksimin e Krimesë dhe konfliktin në lindje të Ukrainës, duke shfrytëzuar edhe vështirësitë e funksionimit të mekanizmit të vendimmarrjes së dakordësuar brenda BE, por edhe duke bërë oferta konkrete ndaj SHBA. Kjo do jetë çështje e mprehtë në normalizimin e marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë e për mbushjen e mëtejshme të tyre.

Ky synim është i vështirë, sepse argumenti që ka përdorur perëndimi nuk është ekonomik e tregtar, por shumë substancial e krucial: është çështja e qëndrimit ndaj ligjit dhe e së drejtës ndërkombëtare. Nuk besoj se mund të ketë argumente plus Rusia, që t'i ketë përdorur në takimin kokë më kokë me Putinin, apo t'i hedhë në vazhdim që të provojë se nuk ka shkelur ligjin ndërkombëtar apo që argumenti i perëndimit nuk qëndron apo është i dobët. Argumenti i konsumuar pas aneksimit të Krimesë, me një lloj të diskutueshëm referendumi, nuk është bindës. Po kështu, edhe shpërthimi konfliktit në lindje të Ukrainës, mbështetja e gjithanshme me armë e mbështetje të tjera ndaj atyre që quhen "separatistë prorusë", kthimi i tij në fakt në një konflikt të ngrirë, në kushtet kur Rusia bashkë me SHBA dhe Britaninë është nënshkruese e memorandumit të Budapestit më 1994, ku angazhohet të respektojë sovranitetin e integritetin territorial të Ukrainës, është një problem shumë i vështirë, që nuk mund të kapërcehet me një propozim për referendum, qoftë dhe me monitorim ndërkombëtar. Nga SHBA ka ardhur edhe një qëndrim konkret për këtë propozim, që e quan të pamundshëm një referendum, kur qeveria ukrainase nuk ka kontrollin mbi këtë territor të saj kushtetues. Nuk mund të mos sillet në vëmendje këtu fakti që Rusia, edhe pse ka nënshkruar të dyja marrëveshjet "Minsk", nuk ka plotësuar detyrimin e saj për t'i kthyer Ukrainës kontrollin e kufirit me të. Nuk besoj se strategjia e demonstrimit të fuqisë ushtarake do të jetë efektive për të prodhuar ndonjë "argument" apo ndonjë kompromis jo të ndershëm e në respekt të ligjit e të drejtës ndërkombëtare në zgjidhjen e konfliktit në Ukrainë.

Takimi i parë i Helsinkit mes presidentit amerikan, Trump dhe presidentit rus, Putin dhe i dyti që mund të realizohet nga fundi i këtij viti, para zgjedhjeve në SHBA është një zhvillim pozitiv, që normalizon dhe ushqen dialogun dhe largon konfrontimin. Ai vlen dhe si kusht e paradhomë për të normalizuar edhe marrëdhëniet, edhe pse ka një problematikë shumë komplekse të krijuar, që do ta vështirësojë këtë normalizim, që do të kërkonte më shumë vullnet dialogu, më shumë përgjegjshmëri të lartë ndaj stabilitetit, sigurisë e paqes, por edhe një respektim, pa lëkundje e pa kompromisin më të vogël ndaj ligjit ndërkombëtar. Normalizimi i marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë është vërtet me shumë interes për sigurinë e stabilitetin në botë, por që nuk mund të kryhet realisht, në kushtet kur në strategjitë e mbrojtjes e të sigurisë, të rinovuara çdo vit, e konsiderojnë armik njëra-tjetrën.

A mund të fillojë një normalizim i vërtetë mes tyre pa kthyer besimin dhe pa e ushqyer me lëndë konkrete këtë besim? A mund të shihet një përmirësim, pa deklarime dhe hapa konkretë, që dëshmojnë vërtet një respektim të plotë të ligjit ndërkombëtar, të traktateve e marrëveshjeve të rëndësishme të nënshkruara, pa një respektim të plotë të organizmave dhe institucioneve të rëndësishëm ndërkombëtarë? A mund të flitet për përmirësim të marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë, në kushtet kur aleatë të SHBA, si vendet Balltike, nuk ndjehen të sigurt, madje ndjehen të kërcënuara nga Rusia? Po kështu, në këtë normalizim ka rëndësi të veçantë filozofia e dialogut mes SHBA dhe Rusisë, që deri tani ka munguar, apo është reduktuar në shtrëngime duarsh. Duke e vlerësuar shumë çështjen e sigurisë në kushtet e sotme, kancelarja Merkel me të drejtë kërkon lëndë e rezultate konkrete, sa i përket sigurisë dhe stabilitetit në botë, të ardhmes së njerëzimit. "Ne - ka theksuar ajo duke e mbështetur këtë dialog - duhet të mësohemi me faktin se takimet mes presidentit Trump dhe presidentit të Rusisë Putin do të bëhen normalitet". Dhe me këtë vlerësim, kancelarja Merkel, duke iu referuar çështjes së mprehtë të sigurisë në botë shpreson që Putin dhe Trump do të bisedojnë për çarmatosjen bërthamore, aq më tepër, kur këto dy vende kanë 90% të armëve bërthamore në botë sot. Reagimi i kancelares Merkel në këtë moment, kur ka edhe një grindje brenda perëndimit është një lëvizje në drejtimin e duhur.

Përmes një bisede mes Lavrov dhe Pompeo, mësohet se të dyja palët po diskutojnë mënyrat për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe, mbi baza të barabarta dhe reciprokisht të dobishme. Ky koncept e kjo filozofi pune vërtet mund të vlerësohet pozitivisht, sepse do të udhëheqë diskutimin e temave vërtet të vështira e komplekse, tashmë të njohura botërisht. Kjo, apo një ndryshim i vërtetë i cilësisë së marrëdhënies mes SHBA dhe Rusisë do të kërkojë edhe kohën e caktuar. Megjithatë, deklarata e Lavrov, që i kërkon homologut amerikan lirimin e një qytetareje ruse, me argumentin se ndalimi i saj është bërë, mbështetur në akuza të fabrikuara e kështu të papranueshme, kur institucionet juridike nuk kanë folur akoma, të kujton klimën e luftës së ftohtë. Natyrisht, nuk mund të pritet një kthesë e menjëhershme e befasuese, por që dëshmon se normalizimi i marrëdhënieve do të jetë shumë i komplikuar e me rreziqe të mëdha, nëse mban parasysh edhe tema akoma më të mprehta. Një ndryshim i vërtetë i marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë do të vinte vërtet përmes një dialogu konstruktiv e natyrisht, që do të fillonte me takimet në nivele kaq të larta, si ai mes presidentit amerikan, Trump dhe presidentit rus, Putin. Ata do të kenë rol të rëndësishëm, që ky ndryshim i marrëdhënieve të ndodhë vërtet, por edhe përgjegjësinë, nëse do të dështojë.

***Më 24 korrik 2018***

Opinioni i Ditës

# “Rusi 2018”, topi që zbuti botën

Nga Dominique Moisi

*(vijon nga faqja 1)*



... i përshkruan ata ashtu siç ata janë”. Për europianët, e sidomos për francezët, Kupa e Botës 2018 ishte një ngjarje Corneilliane. Turneu njëmujor i futbollit në Rusi ofroi një pushim nga një botë e trazuar dhe zbuloi engjëjt më të mirë të natyrës sonë.

Në kundër-realitetin e turneut mbizotëroi një gjendje vetëbesimi, altruizmi dhe të qenit i hapur ndaj “tjetrit”. Të paktën për pak kohë, shovinizmi, tjetërsimi dhe dëshpërimi që kanë dominuar këtë epokë nacionalizmi populist duket se u harruan.

Gjeografikisht, të katër gjysmëfinalistet – Franca, Kroacia, Belgjika dhe Anglia vinin nga kontinenti i vjetër. Denoncojeni sa të doni Europën për dobësinë dhe dekadencën e saj të supozuar. Kur bëhet fjalë për sportin më popullor në botë, Europa është më e mira.

Për më tepër, është e qartë se Afrika është kontinenti i futbollit të së ardhmes, ndërsa Amerika Latine është kontinenti i së kaluarës. Pasi fitoi Kupën në vitin 1930 dhe përsëri në vitin 1950, Uruguai dikur ishte vendi më i vogël (nga popullsia) që arriti në finale. Por, ky nder tani ndahet nga ekipi i guximshëm dhe i vendosur nga Kroacia, shteti më i ri i BE.

Në kontrast të thellë me “botën reale”, dy fuqitë kryesore, Shtetet e Bashkuara dhe Kina nuk luajtën asnjë rol në turne. Ëndrra e ish-sekretarit të shtetit të SHBA-ve, Henry Kissinger për t’i kthyer SHBA-të në një fuqi të madhe futbolli vërtetoi të ishte më e vështirë nga sa shpresonte ai. Dhe Kina nën drejtimin e presidentit Xi Jinping mbetet një peshë e lehtë, pavarësisht se ka investuar miliarda dollarë në sport. Në vend të kësaj, Amerika e Veriut u përfaqësua nga Meksika dhe Azia nga Japonia e Koreja e Jugut.

Divergjenca e çuditshme midis botës reale dhe botës së futbollit këtë vit ishte gjithashtu e dukshme në shprehjet e emocioneve nacionaliste. Shkrimtari i madh argjentinas, Jorge Luis Borges, dikur e dënoi sportin për rolin e tij në nxitjen e formave toksike të nacionalizmit (siç ishte lufta e shkurtër e futbollit midis Hondurasit dhe El Salvadorit në vitin 1969). Por në Kupën e Botës 2018 – një shekull pas përfundimit të kasaphanës nacionaliste që ishte Lufta e Parë Botërore – mbizotëroi një nacionalizëm “i butë” dhe madje i qetë.

Rusia zor se është një eksponent i fuqisë së butë, megjithatë ajo meriton merita për mungesën e dhunës gjatë turneut. Raportet e shtypit ndërkombëtar treguan tifozët ukrainas dhe rusë që u bashkuan si miq të vjetër. Ndërsa festivali Woodstock i epokës së luftës së Vietnamit ilustroi sloganin “Bëni dashuri, jo luftë”, slogani de facto i Kupës 2018 duket se ka qenë “Topa, jo bomba”.

Përveç kanalizimit të një forme më konstruktive të nacionalizmit, gjysmëfinalistët dhe tifozët e tyre gjithashtu mishëruan veprim efikas kolektiv, altruizëm, sinqeritet dhe tolerancë. Interesante është se ekipet që mbështeteshin tek një lojtar i vetëm i madh – qoftë ky Kristiano Ronaldo i Portugalisë, Lionel Messi i Argjentinës apo Neymar i Brazilit – nuk arritën të shkonin më larg sesa deri në çerekfinale.

Në botën reale të ditëve të sotme, njerëzit gjithnjë e më shumë janë të tunduar të ngrenë mure dhe ta izolojnë veten nga “të tjerët”. E megjithatë, forca e ekipit fitues, Franca, ishte në diversitetin e tij. Brohoritja e këtij viti e “Liberté, Egalité, Mbappé” (për 19-vjeçarin francez Kylian Mbappé) ishte një version më iluminues i sloganit të fitores së Francës në vitin 1998: “Zidane president”.

Në prag të zgjedhjeve presidenciale franceze të vitit 2017, shumë komentatorë politikë përsëritën mantrën, “asnjëherë dy pa tri”. Pas referendumit të Brexit të Mbretërisë së Bashkuar dhe zgjedhjes së presidentit amerikan Donald Trump, ata paralajmëruan se një fitore për Marine Le Pen të Fronti Kombëtar i ekstremit të djathtë mund të përfundonte treshen. Në mënyrë të ngjashme, në fillim të vitit 2018, shumë komentatorë francezë dukej se mendonin se po i afroheshim një tjetër “Maj 1968” ose “Dhjetor 1995”, kur sulmet masive dhe protestat në rrugë paralizuan të gjithë vendin.

Megjithëse ka pasur sulme të kufizuara kundër axhendës së reformës së presidentit francez, Emmanuel Macron, këta komentatorë e kanë kuptuar gabim. Paraleli më i afërt me këtë vit nuk është viti 1968 ose 1995, por viti 1998, kur Franca fitoi për herë të parë Kupën e Botës.

Brenda vendit, fitorja e Francës mund të ketë pak efekt, në mos edhe aspak në popullaritetin e Macronit. Emocionet e futbollit janë të mëdha, por në përgjithësi janë të shkurtra. Në skenën ndërkombëtare, megjithatë, fitorja e Francës mund të ketë një ndikim më të gjatë. Askush nuk mund ta mohojë se “Franca u rikthye”, të paktën në aspektin e futbollit. Vendi është shfaqur si një oazë dinamizmi, realizmi dhe entuziazmi rinor, shumica e të cilave reflektohen edhe te vetë Macroni.

Një pikë e dobët e dukshme është Gjermania. Zakonisht një fuqi e madhe në futboll, ekipi gjerman u eliminua në raundin e parë të turneut të këtij viti, ashtu si edhe politika e saj po hyn në një sëmundje më të thellë. Në terma gjeopolitikë, nëse dikush do të duhet të përmendte dy fitues këtë vit, titujt do të duhet të shkonin për Rusinë dhe Francën./Project Syndicate

Në botën reale të ditëve të sotme, njerëzit gjithnjë e më shumë janë të tunduar të ngrenë mure dhe ta izolojnë veten nga “të tjerët”. E megjithatë, forca e ekipit fitues, Franca, ishte në diversitetin e tij. Brohoritja e këtij viti e “Liberté, Egalité, Mbappé” (për 19-vjeçarin francez Kylian Mbappé) ishte një version më iluminues i sloganit të fitores së Francës në vitin 1998: “Zidane president”.

## HOROSKOPI

### DASHI
Sot mund të jesh në vëmendjen e dikujt. Mund të jeni në gjendje shpirtërore për intimitet dhe pasion. Nëse jeni në një marrëdhënie, planifikoni një mbrëmje të veçantë me të dashurin tuaj. Surprizoni partnerin tuaj me spontanitetin tuaj.

### DEMI
Jini vetvetja në gjithçka që bëni. Kjo është një nga ato ditë kur me padurim prisni të bëni një udhëtim të gjatë. Do të gjeni se ka shumë fuqi në dispozicionin tuaj, dhe besimi në veten tuaj është i paçmueshëm.

### BINJAKET
Mund të jeni rreth disa njerëzve shumë emocionues dhe interesantë sot. Lejojani vetes të kërkoni mjedise ku mblidhen njerëzit krijues. Ditë e bukur për të ndjekur një shfaqje teatrore ose një film në kinema.

### GAFORJA
Ëndrrat, fantazitë dhe dëshirat sekrete mund të dalin sot në sipërfaqe, duke ju bërë që të nisni diçka aventureske. Përdoreni këtë si lëndë djegëse për të mbajtur zjarrit të ndezur brenda jush. Përpiquni t’i bëni ëndrrat realitet.

### LUANI
Ju mund të zhgënjeheni nga ata që kanë qëndrime pompoze dhe mendjemadhësi. Ndoshta mund të jeni xheloz që njerëzit e tjerë po marrin vëmendjen që ju mendoni se e meritoni. Nëse është ky rasti ndryshoni qëndrim.

### VIRGJERESHA
Natyra aktive dhe pozitive e qenies suaj bëhen sot së bashku. Ju do të kuptoni se ekziston një ekuilibër mes këtyre dy aspekteve të jetës suaj dhe se jeni në gjendje të tërhiqni begatinë dhe dashurinë

### PESHORJA
Mund të përjetoni pak tensione dhe rezistencë me dikë gjatë pjesës së parë të ditës, por gjërat kanë gjasa të lehtësohen pasi afrohet mbrëmja. Do të kuptoni se njerëzit do të bëhen më fleksibël pasi dita të mbarojë. .

### AKREPI
Fryma juaj aventureske dëshiron të dalë në pah. Ju ndjeheni më të guximshëm se zakonisht. Nën rrethana normale, ju nuk mund të dëshironi të largoheni larg shtëpisë tuaj pa shoqërinë e një tjetri, por në një ditë si kjo, ju nevojitet vetëm vetja.

### SHIGJETARI
Ju mund të qortoheni për gjëra të caktuara për të cilat ju nuk jeni kujdesur siç duhet. Ndoshta ju keni harruar t’i kushtoni vëmendje disa detajeve që duhet të ndiqen. Mos u mbytni mbi atë që keni bërë gabim. Ka shumë gjëra të mrekullueshme për të festuar.

### BRICJAPI
Shfrytëzojeni këtë ditë për t’u ndriçuar dhe mos u shqetësoni aq shumë për çështjet thellësisht intensive, emocionale të jetës. Kjo është koha për t’i lënë këto gjëra mënjanë dhe mos harroni se qëllimi ynë këtu në Tokë është të jemi të lumtur.

### UJORI
Sot do të keni më shumë nevojë për vëmendjen e të tjerëve. Kini kujdes që të mos jeni të obsesionuar nga ky aspekt. Çështja kryesore është të jeni vetë të lumtur pavarësisht mendimit të të tjerëve.

### PESHQIT
Ju mund të ndjeni një konflikt të brendshëm të vështirë që ju vendos në siklet.
Çfarëdo që vendosni të bëni, angazhohuni ta bëni atë sa më mirë dhe mos lejoni që zhgënjimi ose ndjenja e fajit t’ju prishin ditën.

Investitorët tremben: Irani mund të mbyllë rrugën e furnizimit nga Gjiri Persik

# Konflikti SHBA-Iran rrit çmimin e naftës, Gjermania thirrje për maturi

## *Trump: Asnjëherë mos guxoni të kërcënoni Shtetet e Bashkuara*

Qeveria gjermane ka kritikuar tonin e ashpër në konfliktin mes SHBA dhe Iranit. Replikat mes presidentit amerikan, Donald Trump dhe atij iranian, Hasan Rohani kanë shkaktuar rritjen e çmimit të naftës. Pas shkallëzimit verbal të konfliktit mes SHBA dhe Iranit, ku presidenti Trump i kundërpërgjigjet ashpër presidentit iranian, Rohani "mos na kërcënoni më kurrë", reagon edhe qeveria gjermane. Një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme u shpreh se "ne mbështesim bisedimet dhe dialogun dhe u bëjmë thirrje të gjitha palëve, kjo vlen veçanërisht për palën iraniane, për maturi dhe shtensionim të retorikës." Kërcënimet me dhunë ushtarake nuk janë "asnjëherë ndihmuese". Ndërkohë të hënën replikat e ashpra mes SHBA dhe Iranit çuan në rritjen e çmimit të naftës me 1,8% në 74,41 dollarë për fuçi. Investitorët i tremben faktit, që Irani mund të mbyllë një rrugë shumë të rëndësishme të furnizimit me naftë përmes Gjirit Persik dhe me këtë të shkaktojë ngushtica të mëdha në furnizimin me naftë.





**KËRCËNIMI I IRANIT**

Në fundjavë ishte forcuar toni mes dy vendeve. Presidenti Rohani paralajmëroi në fundjavë nga ndjekja e një politike armiqësore kundër Republikës Islamike. "Amerika duhet ta dijë, se paqja me Iranin është nëna e çdo paqeje dhe një luftë me Iranin është nëna e të gjitha luftërave", citoi agjencia gjysmëzyrtare e lajmeve, 'Isna' kreun e shtetit iranian. "Mister Trump, mos luani me bishtin e luanit." Rohani që përdori këtë proverb persian, u shpreh kështu para diplomatëve.

**TRUMP KUNDËRPËRGJIGJET**

Trump iu kundërpërgjigj ashpër me një referim të drejtpërdrejtë presidentit Rohani. "Asnjëherë mos guxoni të kërcënoni Shtetet e Bashkuara, ndryshe do të vuani pasoja, të cilat nuk i keni vuajtur kurrë më parë në histori. Ne nuk jemi më vendi që pranon fjalët tuaja demente të dhunës dhe vdekjes. Jini të kujdesshëm!" Ndërsa Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo e krahasoi lidershipin iranian me mafian. Ai ka përfituar nga pazaret ilegale, korrupsioni dhe mashtrimi, tha ai. Ndërkohë Irani e akuzoi SHBA se po zhvillon luftë psikologjike dhe ndërhyn në punët e brendshme të Iranit. Presidenti amerikan, Donald Trump që në fillim të presidencës së tij ka kritikuar ashpër Iranin. Ai urdhëroi daljen nga marrëveshja atomike me Iranin, kundër vullnetit të shteteve të tjera nënshkruese. Trump synon një marrëveshje tjetër pasuese, por të cilën Irani e refuzon kategorikisht. Ofensiva fillimisht diplomatike, ndaj Iranit ka nisur. Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, ka ndërmarrë një fushatë për diskreditimin e regjimit iranian të cilin e ka quajtur një regjim që i përngjan mafias. Sipas kryediplomatit amerikan, lideri suprem i Iranit, Ajatollah Ali Kamenei, zotëron një fond sekret prej 95 miliardë dollarësh, që përdoret nga Rojet e Revolucionit Islamik.

BE, skeptike ndaj planeve britanike për Brexit

# Michel Barnier: Nuk jam i sigurt nëse propozimet janë të zbatueshme



Propozimet britanike për marrëdhëniet nach dem Brexit janë pranuar me rezerva në Bashkimin Europian. Para së gjithash idetë për partneritetin ekonomik ngrenë pikëpyetje. Kryenegociatori i BE-së për Brexit, Michel Barnier nuk është i sigurt nëse propozimet britanike për Brexit janë të zbatueshme. E paqartë është, nëse ato janë në interes të BE-së dhe në ujdi me parimet bazë të saj europiane, u shpreh Barnier. Bashkë me ministrat e Europës të 27 vendeve anëtare, Barnier diskutoi në Bruksel planet britanike. Në qendër të tyre zona e tregtisë së lirë me BE dhe vazhdimi i shkëmbimit të lirë të mallrave dhe produkteve bujqësore. Londra synon një "libër rregullоresh të përbashkëta" me BE, për të harmonizuar standardet dhe direktivat. Por këto ide të Londrës lenë pyetje të hapura që duhet të diskutohen me palën britanike,-tha Barnier. Në këtë pikë ai përmendi harmonizimin e tyre me katër liritë themelore të tregut të përbashkët europian për personat, mallrat, kapitalin dhe shërbimet. Si një tjetër pikë delikate për marrëveshjen e planifikuar të daljes nga unioni, Barnier përmendi çështjen e Irlandës. Ende nuk ka ujdi për kufirin mes anëtares së BE, Irlandës dhe Irlandës së Veriut, pjesë e Britanisë së Madhe. Për këtë problem duhet të kemi plan garancie, kërkoi Barnier. Edhe nga Irlanda erdhën tone skeptike. Libri i bardhë i qeverisë britanike është një bazë për t'u diskutuar, tha ministri i Jashtëm Simon Coveney, për radion RTE, por negociatat nuk do të jenë të lehta. Edhe nga kryeqendrat europiane reagimet janë të rezervuara. BE tregohet e hapur, por kjo nuk do të thotë se libri i bardhë gjen mirëkuptim të plotë në BE. Edhe ministri gjerman i Shtetit në Ministrinë e Jashtme, Michael Roth, tha se për BE ka rëndësi vendimtare që 27 vendet e BE të paraqiten të vendosura dhe të ruhet integriteti i tregut të brendshëm. Sipas kryenegociatorit Barnier, marrëveshja e daljes nga unioni duhet të jetë gati deri në tetor apo nëntor, me qëllim që të mundësohet ratifikimi nga parlamentet e vendeve të BE, deri në mars 2019.

SHKURT

### Sulm në Toronto, vdes një vajzë, plagosen 13 të tjerë, ngjarja...

Një person i armatosur ka hapur zjarr në një rrugë në Toronto të Kanadasë, duke vrarë një vajzë të re dhe duke plagosur 13 njerëz të tjerë, një prej të cilëve është në gjendje kritike për jetën. Autori i sulmit ka mbetur i vdekur pasi thuhet se u vra gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë. Sulmi ndodhi në rrugën "Danforth" të dielën në mbrëmje, kur zona ishte e mbushur me njerëz, raportoi gazeta e 'Globe and Mail' në Kanada. Sipas 'BBC', shënjestra e sulmit ka qenë një restorant, por motivi mbetet ende i paqartë. Disa nga të plagosurit u trajtuan në vendngjarje, ndërsa të tjerët u dërguan në spitalet lokale. Kryetari i Bashkisë së Torontos, John Tori, dënoi sulmin dhe tha se ata ishin thjesht disa njerëz të pafajshëm që po shijonin mbrëmjen e së dielës.

### Zhduket studentja Mollie Tibbetts, SHBA në alarm

Autoritetet në SHBA po kërkojnë një studente të Universitetit të Iowa-s, e cila është raportuar e zhdukur të mërkurën pasi kishte dalë për një vrap në mbrëmje. Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave të Qarkut Poweshiek tha në një njoftim për shtyp se Mollie Tibbetts ishte parë për herë të fundit në qytetin e Brooklyn, që ndodhet 50 kilometra në perëndim të Iowa City. "Ne shpresojmë se ajo është diku me ndonjë shoqe ose shok dhe se do të shfaqet të hënën ose të martën dhe çdo gjë do t'i kthehet normalitetit", tha një përfaqësues i policisë. Familjarët e vajzës së zhdukur thanë se ajo kishte qenë në shtëpi duke u kujdesur për qenin dhe më pas kishte dalë për të bërë vrap. Ata kuptuan se diçka nuk shkonte kur ditën tjetër ajo nuk u shfaq në punë.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al